



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 319 Akti

Nr. 375 Vendimi
Tiranë, më 26.4.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bektashi Kryesuese

Valbona Sanxhaktari Relatore

Pamela Qirko Anëtare

në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Maria Tuma, asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Elda Faruku, në datën 22.4.2021, ora 14:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), në bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Artan Hazbi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet “A”, “Ç”, “D” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatorit së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi çështjen, mbështetur në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V Ë R E N :

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Artan Hazbi është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe në bazë të nenit 179/b/3, të Kushtetutës, së Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit Artan Hazbi, u shortua në datën 12.11.2019. Relatore e çështjes u zgjodh, sipas shortit, komisionere Alma Faskaj dhe anëtarë komisionerët Brunilda Bektashi dhe Pamela Qirko. Trupi gjykues ka zgjedhur kryesues për këtë çështje komisioneren Brunilda Bektashi. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Maria Tuma.

3. Në datën 2.12.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016 dhe në respektim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues.
4. Subjekti i rivlerësimit, në datën 3.12.2019, u njoh me përbërjen e trupit gjykues dhe me të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarimin e konfliktit të interesit me anëtarët e tij. Subjekti deklaroi se nuk kishte konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.
5. Komisioni, me vendimin nr. ***, datë 10.4.2020, ka zëvendësuar me short komisioneren Alma Faskaj dhe anëtari zëvendësues në përbërje të trupit gjykues, nëpërmjet shortit, u zgjodh komisionere Valbona Sanxhaktari. Subjekti i rivlerësimit Artan Hazbi u njoh me përbërjen e re të trupit gjykues.
6. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.
7. Trupi gjykues, në datën 16.3.2021, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e mbledhura për kriterin e pasurisë dhe, në vijim, vendosi mbylljen e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Artan Hazbi, vetëm për kriterin e pasurisë dhe, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi barrën e provës për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.
8. Komisioni njoftoi në datën 17.3.2021, nëpërmjet postës elektronike, subjektin e rivlerësimit Artan Hazbi për përfundimin e hetimit kryesisht dhe kalimin e barrës së provës, si dhe iu bënë me dije të drejtat në bazë të ligjit për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, lidhur me rezultatet e hetimit të paraqitura nga Komisioni.
9. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesë për shtesë të afatit lidhur me dorëzimin e parashtrimeve mbi rezultatet e hetimit, e cila u pranua nga Komisioni dhe për këtë është njoftuar më 24.3.2021.
10. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe në datën 11.4.2021 dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet për gjetjet e hetimit administrativ të Komisionit, ku së bashku me shpjegimet i ka kërkuar Komisionit riçeljen e hetimit administrativ për vlerësimin e pasurisë, si dhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit, kontrollin e figurës dhe aftësitë profesionale.
11. Komisioni, pasi ka marrë provat dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, ka pranuar dhe administruar të gjitha provat shkresore të paraqitura prej tij. Komisioni, me vendimin e datës 13.4.2021, ka njoftuar subjektin e rivlerësimit se nuk ka pranuar kërkesën e tij për riçeljen e hetimit administrativ, pasi deri në këtë fazë të hetimit konstatohen problematika lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, për të cilin i ka kaluar barrën e provës për të dhënë shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Nëse subjekti, me shpjegimet dhe me provat e paraqitura, do të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, trupi gjykues, pasi t'i vlerësojë ato, do të vendosë lidhur me ecurinë e procesit të rivlerësimit.
12. Në vijim, Komisioni ka ftuar subjektin e rivlerësimit Artan Hazbi në seancë dëgjimore në datën 22.4.2021, ora 14:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve.
13. Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 22.4.2021, ora 14:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Maria Tuma. Subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm në seancë dëgjimore.
14. Me fillimin e seancës, subjekti i rivlerësimit i paraqiti një kërkesë trupit gjykues duke kërkuar zhvillimin e seancës dëgjimore pa praninë e publikut dhe të medias, në bazë të nenit 20/2 të Kodit të Procedurës Administrative.
15. Trupi gjykues ndërpreu seancën dhe u tërhoq në dhomë këshillimi për të vlerësuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit dhe, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të saj, vendosi të mos pranojë

kërkesën e tij për zhvillimin e seancës dëgjimore pa praninë e publikut dhe të medias duke preluar interesi publik, të cilën ia njoftoi subjektit të rivlerësimit në seancë.

16. Në vijim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit paraqiti një kërkesë tjetër për pezullimin e procesit të rivlerësimit, në bazë të neneve 271, 272 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, derisa të kryhet hetimi nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Berat, në lidhje me një kallëzim penal të depozituar më 9.4.2021, pasi kjo situatë lidhej me një nga çështjet e trajtuara në rezultatet e hetimit.

17. Trupi gjykues ndërpreu seancën dhe u tërhoq në dhomë këshillimi për të vlerësuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit, pas vlerësimit të së cilës e gjen të përsëritur edhe gjatë shpjegimeve të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit. Trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit se nuk e pranon kërkesën e tij deri në këtë fazë të hetimit, duke rezervuar të drejtën për ta vlerësuar këtë kërkesë në raport me vendimmarrjen pas vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të dërguara në vijim të rezultateve të hetimit dhe në tërësi të gjetjeve të Komisionit.

18. Në vijim, trupi gjykues vazhdoi me zhvillimin e seancës dëgjimore, në përfundim të së cilës subjekti i rivlerësimit kërkoi që të vlerësohet pozitiv rezultati i hetimit administrativ në lidhje me pasurinë, të riçelet hetimi administrativ për të tria kriteret, si dhe konfirmimin e tij në detyrë.

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

19. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku nëtarët e Komisionit dhe vëzhguesit ndërkombëtarë hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo *indicie* në tërësi, lidhur me rrethanat e çështjes.

20. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI)¹ ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Artan Hazbi ku, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera lidhur me të, ka konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka mosdeklarim pasurie ndër vite;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *bashkëjetuesja e subjektit ka qenë në situatën e konfliktit të interesave.*

21. Pavarësisht se sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është autoriteti përgjegjës për kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë për subjektet e rivlerësimit, referuar vendimit nr. 2/2017², të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni kryen një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË NGA KOMISIONI

22. Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *Vetting*, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së

¹Procedura e vlerësimit të pasurisë: 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me këtë ligj, ligjin, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative.

²“41.Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VIII të ligjit nr. 84/2016, rezultoi se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

23. Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasuritë, si vijojnë:

1. Tokë bujqësore me sip. 6.540 m²: 2.900 m² tokë arë, ndodhur në bllokun ***, parcela ***; 2.600 m² tokë arë, ndodhur në “***”; 140 m² pemëtore, ndodhur në ***, *** (portokalle); si dhe 500 m² pemëtore (ullinj), ndodhur në “***”. Kjo pasuri është përfituar nga ligji nr. 7501, “Për tokën”, nga familja bujqësore H. H., me AMTP-në nr. ***, në Konispol. Pjesa takuese: 100%.

1.1 Subjekti përcjell me deklaratën *Vetting*: aktin e marrjes së tokës në pronësi nr. *** familjes së shtetasit H. H. me vendndodhje në Konispol, Sarandë, gjithsej me sip. 6.540 m²; Certifikatën e Trungut të Familjes së vitit 1991 të z. H. H., me pjesëtarë shtetasit H., D. dhe Artan Hazbi; vendimin nr. ***, datë 8.2.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësve H. dhe D. H., si dhe përcaktimin si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë shtetasit A., R. dhe Artan Hazbi, të cilët përfitojnë nga 1/3 pjesë/secili të të gjithë pasurisë trashëgimore; deklaratën e nënshkruar, datë 29.2.2016, nga shtetasi A. H., i cili deklaroi se nuk ka asnjë pretendim në lidhje me banesën prindërore dhe tokën bujqësore të marrë me AMTP nga familja bujqësore e prindërve, të cilët në vitin 1991 kanë qenë në trung familjar vetëm me vëllain Artan Hazbi.

1.2 ASHK³-ja Sarandë konfirmon se familjes së shtetasit H. H., me AMTP-në nr. ***, i jepet në pronësi sipërfaqe toke në total 6,140 m², sipas ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”. Gjithashtu, konfirmohet aplikim nga shtetasi Artan Hazbi, datë 24.10.2011, për regjistrimin dhe lëshimin e Certifikatave të Pasurive nr. ***, z. k. ***, vol. *** f. ***, në Konispol; nr. ***, vol. ***, f. ***, në Çiflig dhe nr. ***, vol. ***, f. ***, në Çiflig. Z. Artan Hazbi, në bazë të dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. ***, datë 8.2.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ka të regjistruar 5/9 pjesë në bashkëpronësi me shtetasit R. H. 2/9 pjesë dhe A. H. 2/9 pjesë, të pasurive: (a) nr. ***, tokë “arë” me sip. 2,200 m² sipas AMTP-së dhe 1,900 m² sipas matjeve; (b) nr. pasurie ***, pemëtore me sip. 10,580 m² sipas matjeve, Çiflig; (c) nr. ***, tokë “arë” me sip. 2.600 m² sipas AMTP-së dhe 2,967 m² sipas matjeve, Konispol.

1.3 Nga sa rezulton më sipër ka mospërputhje ndërmjet sipërfaqeve të tokave bujqësore sipas AMTP-së dhe sipas matjeve fizike. Këto mospërputhje janë rregulluar me kërkesë të pronarëve me urdhër nr. ***, datë 11.9.2018, të ZVRPP-së Sarandë, ku konstatohen mospërputhjet e sipërfaqes faktike me atë të përfituar nga AMTP-ja dhe urdhërohet zyra e regjistrimit të pasurive të bëjë regjistrimin sipas relacionit tekniko-ligjor të Bashkisë Konispol dhe AMTP-së. Bashkëlidhur me deklaratën përcillen edhe certifikatat e pronësisë së pronave të mësipërme. Pas sistemimeve përkatëse të mësipërme, në ZVRPP është depozituar Deklarata Noteriale nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 13.9.2018, lidhur në Sarandë përpara noterit Th. K., midis shtetasve Artan, A. dhe R. H., ku deklarohet se shtetasit A. dhe R. H. kanë hequr dorë nga bashkëpronësia me nga 29 pjesë/secili për tokën bujqësore të përfituar sipas ligjit nga trashëgimia ligjore për: (a) pasurinë e llojit “arë” me sip. 2,600 m², nr. ***, z. k. ***, në Konispol, e rivlerësuar në shumën 24,700 (njëzet e katërmijë e shtatëqind) lekë; (b) pasurinë e llojit “ullishte” me sip. 500 m², nr. ***, z. k. ***, në Konispol; (c) pasurinë e llojit “arë” me sip. 2,900 m², nr. ***, z. k. ***, në Çiflig, Konispol.

1.4 Gjithashtu, është përcjellë edhe Kontrata e Shkëmbimit (pasuri e paluajtshme) nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë 13.9.2018, lidhur përpara noterit Th. K., në Sarandë, me palë R. dhe Artan Hazbi, ku kanë shkëmbyer pasurinë e llojit “arë” me sip. 2,900 m², në Çiflig, Konispol, të regjistruar në emër të z. Artan Hazbi me pasurinë e të llojit “arë”, me sip. 1,713 m², z.k. ***, nr. pasurie ***, në Konispol, të z. R. H.. Bashkëlidhur përcillen edhe certifikatat e të dyja pronave, me hartat treguese dhe certifikatat familjare të palëve në kontratë.

³ Shihni shkresën nr.*** prot., datë 8.2.2021, në dosjen e Komisionit.

1.5 Në vijim, subjekti shpjegon se deklaratimet kanë qenë me përafërsi, pasi ato janë pasuri të ligjshme dhe të përfituara nga familja bujqësore sipas legjislacionit në fuqi.

1.6 Në përfundim, për këtë pasuri rezulton se subjekti i rivlerësimit është pronar i pasurive të deklaruara në deklaratën *Vetting*, të cilat janë përfituar fillimisht me AMTP nga familja bujqësore dhe pas vdekjes së prindërve i kanë kaluar atij dhe vëllezërve në bazë të trashëgimisë ligjore dhe, më tej, vëllezërit kanë hequr dorë nga pjesët takuese të tyre duke ia kaluar subjektit të rivlerësimit Artan Hazbi.

2. Pasuria e llojit “truall” me sip. 150 m² + banesë/ndërtesë 57.3 m², regjistruar në ZVRPP- në Sarandë në emër të subjektit të rivlerësimit Artan Hazbi, me Certifikatën për Vërtetim Pronësie, datë 9.11.2011, z. k. *, nr. pasurie ***, Konispol.**

2.1 Kjo banesë private ka një verandë me sip. 20 m² dhe një depo me sip. 20 m², në katin përdhes, sipas certifikatës së trungut familjar për shtetasit H. H., D. H. dhe Artan Hazbi. Pas vdekjes së prindërve, H. H. më 25.1.2000 dhe D. H. më 18.5.2010, të dy vëllezërit A. dhe R. H. kanë hequr dorë nga pasuria e lënë si trashëgim nga prindërit për shkak se kanë qenë familje më vete në vitin 1991, janë trajtuar me AMTP më vete dhe kanë ndërtuar banesat e tyre, në të dyja anët e banesës prindërore, në truallin që ka pasur babai që në vitin 1947. Çmimi i shitjes për një sipërfaqe të tillë në Konispol varion rreth 2,500,000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë. Subjekti i rivlerësimit e ka përfituar pa pagesë. Pjesa takuese: 100%.

2.2 Subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën para fillimit të detyrës së vitit 2003: *“Shtëpi banimi e ndërtuar para viti 1990, me sip. rreth 100 m², pronë e nënës sime. Vlera 3,000,000 lekë. Pjesa zotëruese: 50%. Shtëpi banimi në Konispol e ndërtuar para viteve '90 nga 2 prindërit e mi, pronë e nënës sime, pasi 2 vëllezërit e tjerë që kam janë të martuar dhe të ndarë, me shtëpi më vete. Shtëpi fshati e trashëguar”*.

2.3 ASHK⁴-ja Sarandë konfirmon se shtetasi Artan Hazbi ka të regjistruar pasurinë nr. ***, truall me sip. 150 m² dhe ndërtesë me sip. 57.3 m², z. k. ***, në Konispol duke përcjellë: aplikim nga shtetasi A. H., datë 24.10.2011, për regjistrimin dhe lëshimin e Certifikatës së Pasurisë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në Konispol; shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2011, nga Bashkia Konispol drejtuar ZVRPP-së Sarandë për korrigjim gabimi të pasurisë nr. ***, truall me sip. 300 m² dhe ndërtim me sip. 123.3 m², që rezultoi të jetë e regjistruar gabimisht në emër të shtetasit R. H., pasi në këtë numër pasurie pasqyrohen dy banesa dhe, konkretisht: shtetasi R. H. ka në pronësi pasurinë truall me sip. 150 m² dhe sip. ndërtimi 66 m², si dhe shtetasi A. H. ka në pronësi sip. 150 m² dhe 57.3 m² dhe për këtë arsye kërkohet të bëhen korrigjimet përkatëse; Deklaratë Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.10.2011, nënshkruar nga anëtarët e familjes së z. R. H. H., të cilët deklarojnë se pasuria e lloji “truall” me sip. 300 m², nr. ***, vol. ***, f. *** dhe ndërtesë me sip. 123,3 m² e regjistruar në ZVRPP- në Sarandë, në emër të familjes së tyre, gabimisht si e gjitha në pronësi të tyre, pasi ajo është pasuri në pronësi me pjesë të ndryshme të dy familjeve, R. H. H. dhe A. H. H.. Pjesa në pronësi të familjes së shtetasit R. H. është truall me sip. 150 m² dhe ndërtesë me sip. 66 m², ndërsa pjesa e shtetasit Artan Hazbi në këtë pasuri të paluajtshme është truall me sip. 150 m² dhe ndërtesë me sip. 57.3 m². Me anë të kësaj deklaratë, anëtarët e familjes së z. R. H. kanë kërkuar të bëhen korrigjimet përkatëse në ZVRPP- në Sarandë.

2.4 Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, subjekti ka deklaruar se toka ka qenë e babait të tij para vitit 1947 dhe se ndërtesa është ndërtuar para viteve 1990 nga prindërit. Subjekti përcjell⁵ me deklaratën *Vetting* edhe dokumentacion provues⁶ të marrë nga Këshilli i Qarkut Vlorë, në të cilin ndodhen fotokopje të pronave të vitit 1947, në emër të shtetasit A. Sh., në Konispol dhe në Nënprefekturën Vlorë, ku provohet se z. H. H. ka qenë i regjistruar në Regjistrat Themeltarë të viteve 1945 – 1950, të banorëve në Konispol.

⁴ Shihni shkresat nr. ***, datë 9.8.2017, datë 11.10.2017 dhe nr. ***-prot., datë 9.10.2017 Aneks 27 (dosja ILDKPKI) dhe shkresa nr. *** prot., datë 8.2.2021, në dosjen e Komisionit.

⁵ Shihni vërtetimet e përcjella nga Këshilli i Qarkut Vlorë në aneks *** (dosja ILDKPKI).

⁶ Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 23.5.2016, lëshuar nga Këshilli i Qarkut Vlorë; vërtetim nga Zyra e Gjendjes Civile Sarandë; certifikatë familjare e viteve 1945-1950, me kryefamiljar Z. H.; certifikatë familjare me kryefamiljar H. H. të viteve 1950 - 1974, si dhe ajo e vitit 1991.

2.5 Subjekti, i pyetur nga Komisioni⁷ gjatë hetimit nëse kishte ndërtuar një objekt të ri të banesa e vjetër, shpjegon se në lidhje me shtëpinë prindërore në Konispol, prindërit e tij të ndërë me kursimet dhe të ardhurat e tyre nga puna, ekonomia ndihmëse dhe pensionet, përpara shumë vjetësh, pjesë-pjesë kanë rikonstruktuar katin e dytë të saj jashtë dhe brenda. Bashkëlidhur dërgohen fotografi të shtëpisë në Konispol.

2.6 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri rezulton se:

- a) trualli dhe ndërtesa e prindërve të subjektit janë krijuar para viteve 1990;
- b) nga fotot e përcjella në Komision gjatë hetimit duket se banesa është dykatëshe dhe e ndërtuar rishtazi, në ndryshim nga ajo në dokumentin e ASHK-së me sip. 57.3 m²;
- c) kjo pasuri është në pronësi të subjektit të rivlerësimit, duke përfituar të gjitha pjesët takuese të bashkëpronarëve të tjerë dhe, për këtë, duhet të shpjegojë mbi:
 - (i) burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për të ndërtuar këtë banesë nga prindërit, me sip. 57.3 m², verandë rreth 20 m² dhe një depo rreth 20 m² në katin përdhes; si dhe
 - (ii) burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e katit të dytë të banesës në vitet në vijim dhe dokumentacion ligjor përkatës.

2.7 Në bazë të nenit 52, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

2.8 Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti shpjegon se: “... shtëpia e babait ka qenë ndërtuar të paktën që në vitin 1945. Kjo shtëpi ka qenë ekzistuese deri në vitet '90 dhe burimi i krijimit të pasurisë për ndërtimin e saj lidhet me stërgjyshërit, gjyshërit dhe prindërit e mi.

Përpara viteve 2000, kjo shtëpi u restaurua pjesë-pjesë. Për restaurimin e saj nuk ka dokumentacion. Për restaurimin e saj janë përdorur materiale rrethanore si rërë e lumit, gëlqere, etj., që janë nxjerrë dhe marrë privatisht. Punimet i kanë kryer pjesëtarë të familjes si të afërm dhe miq, siç bëheshin në fshat ndërtimet me kontribut vullnetar, por edhe me ndonjë usta. Restaurimi është bërë me të ardhurat nga kursimet e pagave, pensione ve të prindërve, si dhe nga të ardhurat e krijuara nga ekonomia familjare (shpendë, bagëti, park bletësh, dhe pemëtari). Puna dhe ekonomia në atë kohë, përgjithësisht, kanë qenë në informalitet sepse ishte viti 1996 dhe më pas viti i mbrapshtë 1997, ku për shkak të firmave piramidale shpërtheu lufta civile, si dhe fillimi i vitit 1998. Fakti që shtëpia ka qenë e ndërtuar edhe para viteve '91, si dhe që është rikonstruktuar rreth viteve 1996 – 1998 e provon edhe shkresa e Bashkisë Konispol datë 7.4.2021”.

2.9 Për të provuar burimin e të ardhurave, subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur me shpjegimet e tij: (a) vërtetimet nga ISSH-ja, Sarandë: për nënën D. H. që përmban tabelën e të ardhurave mujore të pensionit të pleqërisë për periudhën 16.5.1994 – 18.5.2010; si dhe për babain, i cili është trajtuar me pension pleqërie për periudhën 23.2.1988 – 18.1.2000, me masë mujore fillestare 610 (gjashtëqind e dhjetë) lekë; (b) foto të shtëpisë së prindërve në vitet e kaluara dhe vërtetimin datë 4.4.2021, nga Bashkia Konispol, në të cilin konfirmohet se banesa e shtetasit H. Sh. H. ka qenë e ndërtuar para viteve 1940 – 1950, e rikonstruktuar nga viti 1996 deri nga mesi i vitit 1998, jo me shoqëri ndërtimi, por me ndihmën e familjarëve të tij etj., gjë për të cilën nuk ekzistojnë dokumente.

2.10 Lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues krijoi bindjen se ajo është rikonstruktuar dhe ndërtuar (shitesat mbi ndërtesën ekzistuese) nga të ardhura të subjektit të rivlerësimit, për sa kohë që është edhe përfituesi i vetëm i kësaj pasurie pas vdekjes së prindërve, duke marrë edhe pjesët takuese të vëllezërve. Në këtë logjikë, si dhe nga vlerësimi i të ardhurave të prindërve si pensionistë, që prej viteve 1996 – 1998, rezulton se kanë qenë në pamjaftueshmëri financiare për ndërtimin dhe rikonstruksionin e kësaj banese. Nga hetimi ka rezultuar se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit⁸ kanë shërbyer për të krijuar edhe pasuri të tjera gjatë kësaj periudhe (shihni më poshtë në vendim). Gjithashtu, i paprovuar mbetet momenti i rikonstruksionit dhe

⁷ Shihni përgjigjen nr. 6 të pyetësorit datë 23.12.2020.

⁸ Z. Artan Hazbi ka qenë hetues që prej vitit 1990, në vitin 1997 ka filluar punë si OPGJ dhe që prej vitit 2005 ushtron funksionin si prokuror.

ndërtimi i shtesës së katit, i cili duket se është bërë pa lejet përkatëse, por referuar pamjeve të fotove duket se ndërtimi nuk është shumë i hershëm.

2.11 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri.

3. Pasuri e llojit “truall” me sip. 306 m² për ndërtim banese. Subjekti është pajisur me Vërtetim Pronësie, datë 26.1.2016, për pasurinë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, rruga “****”, Sarandë. Trualli është përfituar në bazë të vendimit nr. ***, datë 15.3.1996, të Këshillit Bashkiak të Sarandës. Me Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.11.2001, përpara noterit publik në Sarandë shtetasi Artan Hazbi e ka blerë truallin në shumën 146,880 (njëqind e dyzet e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat nga kursimet e subjektit dhe të familjes. Pjesa takuese: 100%.

3.1 ASHK⁹-ja Sarandë konfirmon se shtetasi Artan Hazbi ka të regjistruar me vërtetim pronësie pasurinë truall me sip. 306 m², nr. ***, z. k. ***, Sarandë. Për këtë pasuri është bërë rivlerësimi në vitin 2011, në vlerën 5,195,574 (pesë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë dhe në vitin 2017, në vlerën 3,297,462 (tre milionë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë.

3.2 Subjekti i rivlerësimit ka përfituar me vendimin nr. 4, datë 15.3.1996, pasurinë truall me sip. 306 m² si “sipërfaqe truall për ndërtim”, e ndodhur në lagjen nr. ***, ***, Sarandë, të Këshillit të Bashkisë Sarandë, dhënë shtetasit Artan Hazbi për sheshndërtim, parcela nr. ***, me sip. 306 m². Subjekti ka deklaruar se trualli do të përdoret për të ndërtuar banesë private dhe me Lejen e Ndërtimit nr. *** prot., datë 22.12.1998, për dhënien e sheshndërtimit për objektin në zonën ***, parcela nr. ***, me sip. 306 m², leja i jepet shoqërisë “****” sh.p.k. dhe objekti financohet nga z. Artan Hazbi (investitor).

3.3 Subjekti, i pyetur nga Komisioni¹⁰ lidhur me dy rivlerësimet e kryera, shpjegon se: “... nuk më kujtohet rivlerësimi i vitit 2011, por mendoj se vlera e rivlerësuar e truallit në vitin 2017 është më e ulët për shkak se rivlerësimi në këtë rast është bërë duke u mbështetur në çmimin e trojeve të qytetit të Sarandës të përcaktuar me VKM në këtë vit, që duhet të ketë qenë 10,700 lekë/m². Diferenca midis këtij çmimi dhe çmimit të truallit sipas vlerësimit të mëparshëm duhet të ketë qenë më e vogël”.

3.4 Komisioni ka kërkuar shpjegime nga subjekti për mundësitë e tij financiare për të realizuar ndërtimin në vitin 1998 dhe në vijim, se pse nuk është regjistruar kjo pronë ende me certifikatë pronësie, pse nuk është realizuar ky ndërtim dhe çfarë problematikash mund të ketë kjo pronë. Subjekti, për sa më sipër, është përgjigjur se: “... truallin me sip. 306 m², të ndodhur në zonën e quajtur ‘***’ Sarandë, unë e kam përfituar në bazë të dokumentacionit që kam marrë në Bashkinë Sarandë për ndërtimin e një banese. Për ndërtimin e banesës unë veç përdorimit të kursimeve të mia personale dhe familjare do t’i drejtohesha një banke për të marrë kredi, por në kushtet kur Bashkia Sarandë ende edhe sot nuk ka ndërtuar infrastrukturë (rrugë) për të shkuar te ky truall nuk kam aplikuar dhe nuk kam marrë kredi për të ndërtuar në këtë truall. Me shpresën se nga Bashkia do të bëhej dikur rruga, unë këtë truall e kam blerë, e kam rivlerësuar dhe e kam regjistruar në ZRPP-në Sarandë. Herë-herë diskutohej që zona ku ndodhet trualli që unë kam blerë do të ishte zonë e gjelbër, herë-herë diskutohej që do të ndërtohej infrastruktura dhe zona do të zhvillohej. Kështu që nga njëra anë nuk kishte garanci për të ndërtuar për disa faktorë dhe nga ana tjetër kur e kisha marrë një të drejtë (dokumentacionin) më vinte keq ta humbisja atë, prandaj edhe e kam blerë truallin. Jam pajisur me certifikatë pronësie për këtë truall. Nuk kam asnjë problematikë me askënd për të. Aktualisht, me sa jam në dijeni, në bazë të një akti ligjor VKM nr. 329, datë 22.5.2019, janë në procedurë regjistrimi dhe marrje të certifikatës së pronësisë të gjithë personat që me vendime nga ish-këshillat bashkiakë janë trajtuar me troje për ndërtim, por që nuk i kanë paguar më parë trojet. Përfundimisht me sa kam marrë vesh zona ku unë kam këtë shesh në ‘***’ është kthyer në zonë të gjelbër, ku nuk lejohet ndërtimi sipas Planit të Përgjithshëm Vendor të

⁹ Shihni aneksin ***, dosja ILDKPKI.

¹⁰ Shihni përgjigjen nr. 1 në pyetësonin datë 12.7.2020.

*Bashkisë Sarandë, miratuar me vendimin nr. ***, datë 16.10.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit, që ka hyrë në fuqi në datën 19.3.2018”.*

3.5 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri rezulton se:

a) Subjekti ka përfituar në bazë të vendimit nr. ***, datë 15.3.1996, të Këshillit Bashkiak Sarandë, truall me sip. 306 m² dhe në vijim me Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.11.2001, përpara noterit publik në Sarandë, z. Artan Hazbi, e ka blerë këtë truall në shumën 146,880 (njëqind e dyzet e gjashtë mijë e tetëqind e tetëdhjetë) lekë. Duket se subjekti i rivlerësimit ka përfituar këtë pasuri si qytetar i Sarandës për ndërtimin e një banese private, ndërkohë nga hetimi ka rezultuar se ka përfituar më herët me Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.3.1995, nga Enti Kombëtar i Banesave, apartamentin 1+1 me sip. 55 m² + sip. trualli 150 m², Sarandë, duke e përfituar këtë pasuri në mënyrë të padrejtë dhe në kundërshtim me etikën e një prokurori.

b) Në vijim, subjekti nuk ka ndërtuar asnjë banesë mbi këtë truall, por e ka rivlerësuar në vitin 2011 në vlerën 5,195,574 (pesë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë dhe në vitin 2017 rivlerësuar përsëri në vlerën 3,297,462 (tre milionë e dyqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë. Rivlerësimi në vitin 2011 është kryer me shoqëri private, ndërsa në vitin 2017 sipas rivlerësimit të ZVRPP-së. Subjekti rivlerësimit nuk i ka deklaruar këto rivlerësime duke fshehur vlerën reale të kësaj pasurie.

c) Leja e Ndërtimit, dhënë shoqërisë “****” sh.p.k., datë 22.12.1998, duket se është fiktive dhe e kryer vetëm me qëllim përfitimin e këtij trualli dhe më vonë përdorimin për qëllime të tjera të ndryshme nga ato për të cilat është përfituar.

3.6 Në bazë të nenit 52, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

3.7 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegon se: *“Trualli më është akorduar me vendim të Këshillit Bashkiak Sarandë që në vitin 1996. Nuk kam qenë prokuror në këtë periudhë. Është marrë për shtëpi, në përputhje me ligjin dhe si për gjithë personat e tjerë të trajtuar me shesh për ndërtim, jo preferencial dhe pa asnjë abuzim. Terreni ishte i vështirë. Nuk ka pasur fare infrastrukturë, as rrugë, as energji elektrike, as kanalizime etj. Meqenëse nga ana ime u krye pagesa dhe u bë regjistrimi, pavarësisht se nuk u arrit të ndërtohej në këtë truall të blerë, më pas kam kryer rivlerësim duke zbatuar ligjet e shtetit.*

Nuk i kam kushtuar rendësi faktit dhe kam harruar ta deklaroj. Si pronar kam menduar që nëse do të më jepej mundësia të bashkëpunoja për ndërtimin e banesës me 2-3 kate me ndonjë person tjetër ta bëja këtë gjë. E kam rivlerësuar për së dyti, bile në vlerë më të vogël se herën e parë, sepse nuk mbaja mend që kisha kryer edhe më parë rivlerësim, si dhe në ish-ZVPP-në Sarandë në atë kohë në dijeninë time nuk ka pasur sistem. Fakti që unë e kisha rivlerësuar një herë këtë truall dhe nuk e mbaja mend, nuk më është thënë as nga nëpunësit e kësaj zyre. Nëse do ta mbaja mend këtë fakt nuk do të kisha bërë rivlerësim për së dyti dhe në vlerë më të vogël. Aktualisht, me këtë pronë unë kam dalë me humbje pavarësisht se rivlerësimet janë harruar të deklarohen. Kam menduar se rivlerësimin duhej ta deklaroja në momentin që do të kisha ndërtuar shtëpinë vet apo edhe me ortakëri. Në këtë rast kam harruar dhe nuk kam kryer fshehje apo mosdeklarim. Kur i kisha mjetet monetare për të kryer rivlerësimin përse duhet të fshihja këtë veprim?!”

3.8 Lidhur me pasurinë truall me sip. 306 m², trupi gjykues krijoi bindjen se është përfituar për ndërtimin e një banese private për subjektin e rivlerësimit, por ky ka qenë thjesht një pretekst i deklaruar prej tij për përftimin e kësaj pasurie, pasi nuk ka përmbushur qëllimin për të cilin ishte përfituar, e se ai gëzonte një banesë, të përfituar nga Enti Kombëtar i Banesave si i pastrehë, më herët. Shpjegimet e subjektit se kjo pasuri ishte në një zonë të vështirë e të pabanuar nuk duken bindëse, pasi ai vetë ka aplikuar për marrjen e kësaj pasurie, si dhe ka pranuar blerjen e saj para noterit publik në Sarandë. Nga vlerësimi i fakteve dhe provave të rezultuara gjatë hetimit ai ka rivlerësuar pronën në vitin 2011 me vlerësues privat dhe me një çmim të lartë për qëllime të interesave të tij private apo të biznesit. Rivlerësimi i vitit 2017 e

ka kthyer këtë pronë në vlerën sipas çmimit të tregut, përcaktuar me akte nënligjore. Mosdeklarimi në DPV të veprimeve të kryera me këtë pasuri bëjnë të besueshëm faktin se subjekti ka fshehur vlerën reale apo ka kryer veprime të mundshme për tjetërsimin e kësaj pasurie, të cilat mbetën jashtë kontrollit nga ILDKPKI-ja ndër vite.

3.9 Subjekti deklaroi se kjo është një pasuri modeste dhe e pavlerësuar, por në fakt rezultoi me një vlerë ekonomike të lartë, e cila ka shtuar disa herë pasurinë e subjektit të rivlerësimit, dhe e përfituar në mënyrë të padrejtë. Trupi gjykues vlerëson se këto veprime bien ndesh me etikën dhe detyrën e subjektit të rivlerësimit Artan Hazbi dhe se cenojnë figurën e prokurorit. Ai nuk ka deklaruar vlerën reale të kësaj pasurie (të rivlerësuar) në deklaratën *Vetting*, duke e fshehur atë.

4. Pasuri e llojit “truall” për ndërtim me sip. 608 m², rruga “**”, Sarandë.** Për këtë pasuri subjekti është pajisur me Vërtetim Pronësie, datë 5.1.2016, nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***.

4.1 Ky truall është përfituar në bazë të vendimit nr. ***, datë 28.8.1999, të Këshillit Bashkiak, miratuar sheshndërtimi për objektin “hotel”, me sip. të përgjithshme 608 m². Më tej, me Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.6.2002, lidhur përpara noterit publik, shtetasi Artan Hazbi ka blerë truallin me palë shitëse Bashkia Sarandë. Për këtë pasuri ka dalë Leje Ndërtimi, datë 20.12.2001, nga KRRT-ja Sarandë, për shtetasin Artan Hazbi, me objekt “ndërtim hotel H 7-9 Sarandë”.

4.2 Më tej, për këtë pasuri është miratuar nga Bashkia Sarandë, Leje Ndërtimi nr. ***, datë 18.10.2010, zbardhur më 25.2.2011, e cila është dhënë mbi bazën e Kontratës së Sipërmarrjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 9.5.2010, lidhur midis pronarit të truallit Artan Hazbi dhe znj. V. H. si investitore në këtë truall për ndërtimin e objektit “godinë banimi dhe shërbimesh-garazh”, nga shoqëria ndërtuese “****” sh.p.k.

4.3 Në vijim, meqenëse znj. V. H me Kontratën e Porosisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.3.2011, lidhur para noterit publik, ka hequr dorë si investitore dhe me pëlqimin e pronarit të truallit, shoqëria “****” sh.p.k. është bërë edhe investitor edhe ndërtues. Për këtë ndërtim, shoqëria “****” sh.p.k. ka kryer sistemimin e sheshndërtimit dhe për mungesë fondesh, investimi është ndërprerë, duke mos u kryer.

4.4 Subjekti deklaron në DPV-në e vitit 2017, se pas bisedimeve dhe zgjidhjes së çështjes me mirëkuptim, me Deklaratën Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 29.3.2017, bërë përpara noterit publik S. M., në Lushnjë, shoqëria “****” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori G. K., kjo shoqëri heq dorë nga investimi në truallin në pronësi të z. Artan Hazbi, duke kthyer palët në gjendjen fillestare pa asnjë kusht.

4.5 ASHK¹¹-ja Sarandë konfirmon se shtetasi Artan Hazbi ka të regjistruar pasurinë truall me sip. 608 m², nr. ***, z. k. ***, Sarandë, me vërtetim pronësie. Për këtë pasuri është bërë rivlerësim në vitin 2012, në vlerën 11,893,088 (njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e tetë) lekë.

4.6 Subjekti, i pyetur nga Komisioni,¹² shpjegon se: “... siç përmenda edhe në përgjigjen për pyetjet në lidhje me truallin prej 306 m², të ndodhur në zonën e ‘****’ Sarandë, ai truall ishte pothuajse në ‘majë të malit’, pa infrastrukturë dhe, për më tepër, diskutohej që të kthehej në ‘zonë të gjelbër’, siç edhe është kthyer në fakt. Për këtë arsye mu dha mundësia për ta përfituar këtë truall në zonën Turizëm-***. Këtë truall e kam me certifikatë pronësie dhe nuk di të ketë problematika me askënd. Kam menduar se pasi të bëhej zbardhja e lejes së ndërtimit duhej bërë deklarimi i kontratës së sipërmarrjes. Zbardhja e lejes së ndërtimit është bërë më 25.2.2011. Në këto kushte në deklaratën e vitit 2011, e kam pasqyruar kontratën e sipërmarrjes me znj. H. I kam pasqyruar kontratat në DPV-në e vitit 2017”.

4.7 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri rezultoi sa vijon:

¹¹Shihni Aneksin ***, dosja e ILDKPKI-së.

¹²Shihni përgjigjen nr. 2, në pyetësorin datë 12.7.2020.

a) Duket se vlera totale e paguar nga subjekti për këtë pasuri është 392,083 (treqind e nëntëdhjetë e dy mijë e tetëdhjetë e tre) lekë dhe jo 291,840 (dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e dyzet) lekë sipas deklarimeve të subjektit. Subjekti nuk ka deklaruar pagesën e kryer prej tij më 21.6.2002, për Bashkinë Sarandë për pajisjen me lejendërtimi, duke fshehur statusin e tij si investitor në këtë pasuri.

b) Sipas Kontratës së Sipërmarrjes, datë 9.5.2010, investitorja V. H., merr përsipër të gjitha shpenzimet për miratimin e lejes së ndërtimit dhe dokumentacionit ligjor në emrin e saj për fillimin e punimeve. Sipas Deklaratës Noteriale, datë 25.10.2016, të paraqitur në deklaraten *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit, të gjitha shpenzimet janë përballuar nga sipërmarrësi, shoqëria “****” sh.p.k. Këto deklarime duken kontradiktore, nuk vijnë në koherencë me faktet dhe duket se janë kryer për të fshehur të vërtetën.

c) Subjekti nuk ka deklaruar në deklarimin e interesave private periodike vjetore të vitit 2010, Kontratën e Sipërmarrjes, datë 9.5.2010, nënshkruar me palën sipërmarrëse V. H., por e deklaroi në DPV-në e vitit 2011, kur edhe e anuloi. Në këtë periudhë rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit ishte në një lidhje me këtë shtetase që më herët para vitit 2010, e rezultuar nga udhëtimet familjare në sistemin *TIMS*, si dhe lindja e fëmijës së përbashkët. Duket se subjekti ka vepruar një herë vetë dhe njëherë nëpërmjet bashkëjetueses së tij duke kryer investim në kundërshtim me përcaktimet kushtetuese dhe detyrën e tij si prokuror.

d) Subjekti nuk ka deklaruar në deklarimin e interesave private periodike vjetore të vitit 2016, Deklaratën Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.10.2016, nënshkruar ndërmjet shtetasve V. H., Artan Hazbi dhe shoqërisë “****” sh.p.k., sipas së cilës nuk është bërë asnjë shpenzim për realizimin e investimit dhe se të gjitha shpenzimet janë përballuar nga sipërmarrësi “****” sh.p.k., i cili me Kontratën e Porosisë, datë 4.3.2011, është bërë edhe investitor i këtij ndërtimi.

e) Dokumentacioni justifikues ligjor ku palët revokojnë gjithë dokumentacionin fillestar është realizuar në vitin 2017, pas plotësimit të deklaratës *Vetting*. Duket se e tërë historia e lejeve të ndërtimit, ndër vite, si dhe përpjekjet për zhvillimin e kësaj pasurie janë veprime fiktive, pasi edhe pas pothuajse 20 vjetësh, kjo pasuri mbetet e pazhvilluar sipas qëllimit për të cilën është përfituar. Kjo pasuri është blerë në vlerën 291,840 (dyqind e nëntëdhjetë e një mijë e tetëqind e dyzet) lekë dhe është rivlerësuar deri në vitin 2012 në vlerën 11,893,088 (njëmbëdhjetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e tetë) lekë, duke mospërbushur asnjë nga kërkesat ligjore për përfitimin e saj. Subjekti nuk ka deklaruar vlerën e pasurisë së rivlerësuar në vitin 2012, duke fshehur vlerën reale të saj.

f) Subjekti i rivlerësimit ka përfituar nga Bashkia truallin për ndërtim me objekt “ndërtim hotel H 7-9”, Sarandë, të cilin, më tej, e ka tjetërsuar te investitorët “V. H.” dhe më pas te shoqëria “****” sh.p.k., veprime të cilat në fakt nuk janë përmbushur asnjëherë. Kjo pasuri është rivlerësuar në shumëfishin e vlerës së përfituar duke shtuar kështu disa herë pasuritë e subjektit të rivlerësimit.

g) Duket sikur statusi i investitorit ka qenë në çdo rast fiktiv vetëm për të mundësuar lejen e ndërtimit me qëllim përfitimin e pasurisë truall dhe regjistrimin e saj, e cila rezultoi ende pa certifikatë pronësie¹³. Duket se subjekti i rivlerësimit ka përfituar këtë pasuri në mënyrë të padrejtë dhe abuzive, si dhe në kundërshtim me funksionin e tij si prokuror i Republikës së Shqipërisë.

4.8 Në bazë të nenit 52, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

4.9 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegon: *“E kam përfituar në bazë të ligjit dhe pa asnjë privilegj si gjithë të tjerët. E kam regjistruar po ashtu si gjithë të tjerët. Kam marrë leje ndërtimi në vitin 2001, por nuk kam filluar të ndërtoj. Kam harruar të deklaroj lejen e ndërtimit dhe shumë e paguar nga ana ime për këtë leje. I kam pasur mjetet monetare për t’i kryer këto pagesa dhe nuk kam pasur qëllim të fsheh të vërtetën. Kam bashkëpunuar me persona të ndryshëm për ta investuar këtë pronë dhe kam marrë leje ndërtimi përsëri. Lejen e ndërtimit të miratuar në vitin 2010 dhe zbardhur më 25.2.2011 e kam deklaruar në vitin 2012 sepse efektivisht atëherë u vura në dijeni të kësaj lejeje. Kontratën e sipërmarrjes dhe lejen e*

¹³ Pajisja me vërtetim pronësie në vitin 2016 do të thotë që subjekti nuk ka plotësuar kërkesat ligjore për nxjerrjen e certifikatës së pronësisë.

ndërtimit i kam deklaruar me vonesë për këtë shkak. Nuk kam kryer mosdeklarim apo fshehje. Kam harruar të bëj deklarim dhe kam deklaruar me vonesë. Edhe në lidhje me rivlerësimin i kam pasur mjetet monetare për të kryer pagesën, por kam pasur mendimin që në momentin e fillimit të punimeve të bëja këtë deklarim. Nuk kam fshehur, nuk kam bërë mosdeklarim apo deklarim të rremë. Nuk jam në kushtet e konfliktit të interesit dhe mendoj se siç mund ta blej një shtëpi, një truall apo një pasuri të patundshme edhe të ndërtoj një shtëpi, një lokal, një hotel etj.”

4.10 Trupi gjykues i Komisionit, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, vlerëson se ai nuk ka mundur të bindë trupin gjykues mbi të kundërtën e rezultateve të hetimit. Trupi gjykues krijoi bindjen mbështetur në provat e administruara se subjekti e ka përfituar këtë pasuri në mënyrë të padrejtë, pasi kishte përfituar edhe më herët pasuri të tjera publike si banor i Sarandës si dhe ka fshehur vlerën reale të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, duke deklaruar atë të përfitimit të saj në vitin 2002. Subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e konfliktit të interesit, pasi ndërkohë që ushtronte funksionin si oficer i policisë gjyqësore dhe, më pas, si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Sarandë, ka përfituar si investitor një pasuri publike dhënë me qëllim zhvillimin e qytetit dhe nuk ka kryer në vijimësi, në një hark kohor shumë të gjatë, asnjë investim në këtë pasuri duke e trajtuar si pasuri private dhe krejtësisht për qëllime personale, e cila pas rivlerësimit ka shtuar disa herë vlerën e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe i konsideron këto si veprime që cenojnë figurën e tij si prokuror.

5. Apartament banimi me sipërfaqe ndërtimi 77 m², nr. ***, k. ***, lagjja nr.***, me nr. pasurie ***, z. k. ***, Sarandë, blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. me Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.6.2007, lidhur në Sarandë, përpara noterit publik, blerë në shumën 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) lekë. Burim krijimi: të ardhurat nga kursimet e subjektit dhe të familjes. Pjesa takuese: 100% (kjo pasuri është rivlerësuar me vlerën 65,065 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e pesë) euro, në vitin 2017 dhe shkëmbyer me pasurinë truall + ndërtesë në Ksamil, e cila është trajtuar në vijim).

5.1 ASHK¹⁴-ja Sarandë konfirmon pasurinë nr. ***, z. k. ***, apartament me sip. 77 m², Sarandë, në emër të subjektit të rivlerësimit. Për këtë pasuri është bërë rivlerësimi në vlerën 65,065 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e pesë) euro në vitin 2017. Përcillet edhe Kontratë Shitblerjeje nr. *** rep., nr.*** kol., datë 23.6.2007, nënshkruar ndërmjet palës shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palës blerëse Artan Hazbiu për shitjen e apartamentit të banimit me sip. ndërtimi 77 m², me çmim shitjeje të apartamentit në vlerën 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) lekë, i likuiduar tërësisht nga blerësi jashtë zyrës noteriale. Vërtetim nga dokumentet hipotekore, datë 29.5.2007, ku sipas regjistrimit hipotekor nr. ***, f. ***, datë 19.9.2006, figuron e regjistruar në emër të shoqërisë “****” sh.p.k., pasuria me nr.***, apartament banimi me sip. 77 m², lagjja nr.***, Sarandë. Bashkëlidhur harta treguese e regjistrimit dhe vendim gjykate për shoqërinë “****” sh.p.k.

5.2 Në lidhje me çmimin e blerjes, Komisioni e krahasoi me referencën nga EKB¹⁵-ja të vitit 2007, nga i cili rezultoi se çmimi i shitjes për sipërfaqe të shfrytëzueshme në qytetin e Sarandës është 50,537 lekë/m². Në bazë të saj, kostoja totale e pasurisë së subjektit rezulton të jetë¹⁶ 3,891,349 (tre milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e dyzet e nëntë) lekë, e cila është 216 % (ose 2.16 herë) më e lartë se çmimi i blerjes së pasurisë nga subjekti prej 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) lekësh.

5.3 Subjekti, i pyetur¹⁷ nga Komisioni lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie, shpjegon: “... me sa më kujtohet apartamenti i banimit ndodhur në lagjen nr.*** Sarandë, i ndërtuar prej shoqërisë “***” sh.p.k. kishte pasur probleme të rrjetit të ujit. Porositësi e kishte ndërruar apo kishte hequr dorë nga blerja e tij për shkak të lagështirës që krijohej nga rrjedhjet e ujit. Në bisedë me përfaqësues të shoqërisë, unë rashë dakord që ta blija atë apartament. Ramë dakord të gjëja defektin dhe ta bëja vetë me shpenzimet e mia, pas blerjes së apartamentit, por me

¹⁴ Shihni shkresën nr.*** prot., datë 8.2.2021, në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Shihni udhëzim nr. ***, datë 4.4.2007.

¹⁶ Llogaritur 77 m² x 50,537 lekë/m².

¹⁷ Shihni përgjigjen nr. 4 në pyetësorin datë. 23.12.2020.

çmim fare pak më të ulët nga sa do ta merrja nëse do të ishte në gjendje të rregullt. Në këto kushte u realizua blerja me atë çmim. Pra, çmimi për apartamentin dhe për defektin që kishte nuk ishte favorizues”.

5.4 Subjekti nuk deklaroi shpenzime shtesë për këtë apartament, prandaj edhe nuk janë llogaritur në analizën financiare.

5.5 Nga analiza financiare rezultoi se një pjesë e të ardhurave për pagesën e apartamentit ishin tërheqje nga “Raiffeisen Bank”, pjesa e mbetur e detyrimit është shlyer nga subjekti *cash* (1,800,000 lekë – 1,117,550 lekë, pra, 682,450 lekë) deri në datën e lidhjes së kontratës së shitjes (datë 23.6.2007). Subjekti rezultoi në pamundësi financiare për kryerjen e pagesës për apartamentin me të ardhura të ligjshme në vlerën -328,387 (treqind e njëzet e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë.

5.6 Në përfundim, për këtë pasuri rezultoi se:

a) Çmimi i blerjes në vlerën 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) lekë është rreth 2,16 herë më i ulët se çmimet referuese të shitblerjes së pronave në vitin 2007, në qytetin e Sarandës sipas vlerave referuese të EKB-së. Çmimi i rivlerësuar në vitin 2017 është në vlerën 65,065 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e pesë) euro dhe kjo pasuri pas rivlerësimit është këmbyer me pasurinë truall + ndërtesë/hotel, Ksamil. Duket se çmimi i blerjes së pasurisë nuk është real ose subjekti është favorizuar në blerjen e apartamentit me sip. 77 m², në Sarandë, në vitin 2007.

b) Subjekti nuk përcjell prova për kryerje punimesh për riparime në këtë apartament, nuk provon vlera shpenzimesh të kryera, për këtë qëllim, që mund të rrisin vlerën e pasurisë apo të provojnë shpjegimet lidhur me çmimin e ulët të blerjes së saj. Gjithashtu, rezultoi në pamundësi financiare gjatë periudhës së blerjes së apartamentit në vlerën -328,387 (treqind e njëzet e tetë mijë e treqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, duke iu referuar çmimit të deklaruar prej tij.

5.7 Në bazë të nenit 52, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

5.8 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegon se: *“Çmimi i blerjes së apartamentit ka qenë i pranuar nga palët për shkak të defektit në rrjetin e ujit, të cilin mezi e kam rregulluar vite më vonë. Nga rivlerësimi i bërë, këtij apartamenti iu rrit vlera (për shkak se defekti u rregullua dhe ishte në gjendje të mirë, si dhe për shkak të kalimit të viteve ku ajo ishte e pabanuar, në qendër të qytetit, në një kat të mirë etj.).”*

5.9 Subjekti i ka kërkuar Komisionit që të përfshijë në analizë edhe të ardhurat nga shitja e automjetit në vitin 2006, por këto të ardhura nuk deklarohen si shtim i gjendjes *cash* në fund të vitit 2006 dhe as si të përdorura për blerjen e apartamentit në vitin 2007. Gjendja *cash* e deklaruar në vitin 2006 është 0 (zero) lekë.

5.10 Subjekti ka kërkuar të merren në konsideratë edhe të ardhurat nga pensioni i nënës, të cilat trupi gjykues nuk i ka marrë në konsideratë, pasi ajo jetonte në banesën e tyre në Konispol dhe se pensioni ishte në vlerën minimale apo mesatare të mbulimit të shpenzimeve personale, ndërsa subjekti në Sarandë. Edhe nëse do të mbaheshin në konsideratë këto të ardhura, subjekti do të ishte në pamundësi financiare për të krijuar këtë pasuri në vlerën -287,722 (dyqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e njëzet e dy) lekë.

5.11 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se çmimi i blerjes në vlerën 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) lekë është dukshëm më i ulët se çmimet referuese të shitblerjes së pronave në vitin 2007, në qytetin e Sarandës dhe sipas vlerave referuese të EKB-së, megjithëse apartamenti ndodhej në qendër të qytetit (sipas deklarimeve edhe të subjektit kur e ka këmbyer atë), në një zonë të mirë dhe situatë të favorshme. Shpjegimet e subjektit mbeten deklarative. Pasuria ka qenë e regjistruar dhe nuk ka pasur arsye përse të shitej ndjeshëm nën çmimin e referencës duke qenë se ishte edhe një ndërtesë të ri. Çmimi i rivlerësuar në vitin 2017 është në vlerën 65,065 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e pesë) euro, i cili tregon se kjo pasuri ka

pasur një vlerë tregtare të mirë, e provuar kjo edhe me këmbimin e saj me pasurinë truall + ndërtesë/hotel, në Ksamil.

5.12 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar, në vijim, asnjë shpenzim që të ketë rritur vlerën e kësaj pasurie, ndër vite (pa marrë në konsideratë edhe amortizimin natyral që ajo ka pasur), e cila të jetë përfshirë në analizën financiare të Komisionit, pavarësisht se është pyetur disa herë nga Komisioni. Subjekti ka qenë në pamundësi financiare në vitin 2007 për blerjen e kësaj pasurie në vlerën e deklaruar prej 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) lekësh, po ashtu të pajustificuara mbeten edhe shpenzime për investime të mundshme të kryera, të cilat mund të kishin shtuar vlerën e saj. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka blerë një banesë me defekte të dukshme, e cila kishte mbetur pa shitur, por nga ana tjetër nuk e shoqëron këtë arsyetim me kosto reale shpenzimesh apo ndonjë dokumentacion provues.

5.13 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare për të justifikuar blerjen e pasurisë. Trupi gjykues krijoi bindjen se transaksionet e kryera me këtë pasuri ishin të dyshimta [blerë në vitin 2007 për vlerën 1,800,000 (një milion e tetëqind mijë) lekë, rivlerësuar në vitin 2017, në vlerën 65,065 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e pesë) euro dhe këmbyer me një pasuri truall+hotel në Ksamil], duke krijuar bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të rremë, ndër vite, duke fshehur vlerën reale të investimit për këtë pasuri, si dhe ndodhet në mungesë të burimeve financiare të ligjshme.

6. Apartament 1+1, me sip. 55 m² + sip. trualli 150 m², ndodhur në Parkun e Mallrave Sarandë, blerë në vlerën 72,000 (shtatëdhjetë e dy mijë) lekë, me Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 31.3.1995, lidhur përpara noterit publik, përfituar nga privatizimi me Entin Kombëtar të Banesave, blerë me kursimet e subjektit dhe të familjes.

6.1 Me Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.2.1998, subjekti i rivlerësimit ka shitur këtë apartament së bashku me truallin në vlerën n 3,750,000 (tre milionë e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) dhrahmi greke (konvertuar në vlerën rreth 1,875,000 lekë).

6.2 Me deklaratën përcjellë¹⁸ nëpërmjet Kontratës së Shitblerjes nr. *** rep., nr.*** kol., datë 31.3.1995, nënshkruar ndërmjet palës shitëse Dega e Entit Kombëtar të Banesave dhe blerësve Artan, H. dhe D. H. të një apartamenti me sip. 55 m², që ndodhet në banesën nr. ***, kati ***. Çmimi i shitjes së apartamentit në vlerën 72,000 (shtatëdhjetë e dy mijë) lekë, është paguar me mandatarkëtim nr. ***, datë 30.3.1995.

6.3 Komisioni nuk arriti të hetonte mbi mundësinë për krijimin e pasurisë së mësipërme sepse sipas vërtetimeve të institucioneve¹⁹ të përcjella me deklaratën *Vetting* nga subjekti konfirmohet se të dhënat janë djegur gjatë ngjarjeve të vitit 1997. Gjithashtu, nuk u arrit të provohej vlera e pensioneve të prindërve edhe nga hetimi i Komisionit nuk u arrit të siguroheshin vlerat e tyre.

6.4 Në përfundim për këtë pasuri rezultojnë:

a) Subjekti i rivlerësimit dhe prindërit e tij kanë përfituar në vitin 1995, nga Enti Kombëtar i Banesave nëpërmjet procedurave të privatizimit të banesave, apartamentin 1+1, me sip. 55 m², mbështetur në statusin e qiramarrësit të kësaj prone. Më tej, subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë pasuri së bashku me truallin në vitin 1998 me një çmim shumë herë më të lartë dhe duke përfituar në vijim pasuri të tjera në Sarandë me statusin i pastrehë.

b) Duket se subjekti ka blerë në vitin 1995 vetëm apartamentin me sip. 55 m², pasi shitja e trojeve nuk është kompetencë e Entit Kombëtar të Banesave. Fitimi i pronësisë së truallit me sip. 150 m², mbetet i paprovuar dhe i padokumentuar. Subjekti duhet të provojë titullin e pronësisë mbi truallin dhe mënyrën e përfitimit të tij.

6.5 Në bazë të nenit 52, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

¹⁸ Shihni kontratën e shitjes në Aneksin ***, dosja e ILDKPKI-së.

¹⁹ Shihni në Aneks 4/7 (dosja ILDKPKI) - vërtetimet nr. *** prot., datë 24.10.2016, nga Prokuroria Pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; nr. *** prot., datë 26.10.2016, nga DRSSH-ja Berat; vërtetim për vitet 1992 - 1994, nga Sigurimet Shoqërore Sarandë; nr. *** prot., datë 26.10.2016, nga Komisarati i Policisë Sarandë; nr. *** prot., datë 24.10.2016, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

6.6 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegon se: *“Në lidhje me fitimin e pronësisë për sip. 150 m² truall, ju sqaroj se siç më bënë dokumentacion përfaqësuesit e EKB-së Sarandë, kam shkuar dhe kam bërë pagesat përkatëse në bazë të mandatarkëtimit që më kanë dhënë, pra pa e falsifikuar. Personi të cilit ia kam shitur unë këtë pronë aktualisht ka ndërtuar një pesëkatësh në një sipërfaqe baze prej 150 m², pra, në 100 % të sipërfaqes së blerë”.*

6.7 Subjekti ka kërkuar të merren në konsideratë të ardhurat nga pensionet e prindërve dhe paga e tij si OPGj, për të cilat ka përcjellë vërtetimet e pensioneve dhe pagës së tij. Trupi gjykues i ka marrë në konsideratë këto të ardhura, nga analiza e të cilave rezultoi se subjekti ishte në pamundësi financiare për të krijuar këtë pasuri në vlerën -50,881 (pesëdhjetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e një) lekë.

6.8 Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë fitimin e pronësisë mbi truallin me sip. 150 m² dhe nuk ka provuar pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie në vitin 1998. Veprimet e kryera prej tij, duke e shitur këtë pasuri të përfutur për qëllim banimi dhe përfitimi më pas edhe të pasurive të tjera me statusin si i pastrehë, janë veprime që cenojnë etikën dhe figurën e prokurorit.

7. Depozitë bankare në shumën 200,000 lekë. Subjekti shpjegon se ka patur një depozitë bankare në “Credins Bank”, të cilën e ka pakësuar duke e mbyllur plotësisht dhe duke bërë transfertë bankare të saj te “Raiffeisen Bank”. Nga llogaria rrjedhëse e pagës në “Credins Bank”, kursimet në shumën rreth 190,000 lekë transferuar në llogarinë në “Raiffeisen Bank”. Shuma e krijuar afërsisht 2,100,000 lekë futur në llogari duke blerë kuota te Fondi i Investimeve të kësaj banke me afat 1-vjeçar. Mbyllja e depozitës dhe kalimi i saj dhe shumës tjetër nga “Credins Bank” në “Raiffeisen Bank” është bërë më 24.11.2016 dhe blerja e kuotave tek Fondi i Investimeve në “Raiffeisen Bank” është bërë më 30.11.2016. Disponoj gjendje lekësh në sistemin bankar shumën prej 2,100,000 lekësh, që janë vendosur te Fondi i Investimeve në “Raiffeisen Bank” dhe një sasi tjetër prej 29,000 lekësh në “Raiffeisen Bank”, si dhe rreth 32,000 lekë në “Credins Bank”.

7.1 Nga informacioni i administruar gjatë hetimit administrativ nga “Credins Bank²⁰” dhe “Raiffeisen Bank²¹” deklarimet e subjektit përputhen me dokumentacionin shkresor të përcjellë nga institucionet.

8. Gjendje në shumën 210,000 (dyqind e dhjetë mijë) lekë, jashtë sistemit bankar në formën *cash*, nga kursimet e subjektit të rivlerësimit dhe të familjes, si dhe nga shitja e ullinjve për vaj. Në deklaratën *Vetting* është deklaruar gjendje *cash* (janar 2017) në vlerën 210,000 (dyqind e dhjetë mijë) lekë, ndërsa në DPV-në e vitit 2016 gjendja është deklaruar në vlerën 200,000 (dyqind mijë) lekë.

8.1 Nga Komisioni nuk janë konsideruar në analizë financiare të ardhurat nga shitja e ullinjve për vaj sepse nuk kanë dokumentacion ligjor të rregullt. Lidhur me këtë deklaram të subjektit ai është vlerësuar në kuadër të analizës financiare.

9. Aktiviteti i kultivimit të ullinjve. Në vendin e quajtur “****”, vëllai i subjektit, z. R. H., ka një sipërfaqe toke prej 1,800 m², sipas AMTP-së nr. ***. Subjekti deklaroi se: *“... për efekt dokumentacioni këtë sipërfaqe ma ka dhënë me qira siç i kam dhënë edhe unë me qira sip. 2,900 m² tokë arë, ndodhur në bllokun ***, parcela ***, e më pas i kemi shkëmbyer me marrëveshje verbale duke hequr dorë nga qiraja reciproke. Nuk i kemi marrë lekë njëri-tjetrit, prandaj nuk janë deklaruar. Në vendin e quajtur “****”, në mars të vitit 2011 unë kam mbjellë 210 rrënjë ullinj të rinj. Ata janë të regjistruar në Drejtorinë e Bujqësisë Sarandë. Për mbjellat e reja që kam kryer, të cilat vërtetohen edhe me projektin që është aplikuar dhe miratuar nga Drejtoria e Bujqësisë së Rrethit Sarandë jam subvencionuar nga AZHBR-ja në shumën 152,000 lekë, të cilat m’i kanë kaluar nëpërmjet ‘Societe Generale Albania’ sh.a. sipas ekstraktit datë 22.2.2016, të kësaj banke në datat 17.10.2011 dhe 30.11.2011. Në periudhën 2013 – 2016 unë kam krijuar fitime në shumën 70,500 + 190,000 + 205,000 + 220,000 lekë = 685,500 lekë”.*

²⁰ Shihni shkresën nr. ***, datë 31.1.2020, nga “Credins Bank”.

²¹ Shihni shkresën nr. ***, datë 27.2.2020, nga Raiffeisen Invest.

9.1 Subjekti deklaron në DPV-në e vitit 2011 investimin e kryer për ullahtën, vlerën e kompensimit dhe kontratat e qirasë të lidhura me të vëllanë R. H..

9.2 Subjekti përcjell me deklaratën *Vetting* dokumentet për ushtrimin e këtij aktiviteti, si vijon:
a) formularin e pranimit të aplikimit në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria Rajonale Vlorë, aplikim i kryer më 11.3.2011 nga shtetasi Artan Hazbi pranë Qarkut Vlorë, Sarandë;

b) formularin e pranimit të aplikimit për mbjelljet e reja, datë 6.3.2011, nga shtetasi Artan Hazbi, masa e mbështetjes “ullishte”, sipërfaqja e aplikimit 44 ha, z. k. nr. ***, pasuri nr. ***;

c) kërkesën nr. *** prot., datë 1.3.2011, nga Bashkia Konispol drejtuar ZVRPP-së Sarandë për korrigjimin e mbiemrit të shtetasit H. H.u në H. H.;

ç) vendim nr. ***, datë 8.2.2011, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësve H. dhe D. H. dhe përcaktimin si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të shtetasve A., H. dhe Artan Hazbi, të cilët përfitojnë nga 1/3 pjesë secili të të gjithë pasurisë trashëgimore;

d) AMTP-në për shtetasin H. H.; vërtetim, datë 28.2.2011, nga Bashkia Konispol se parcela z. k. *** dhe nr. *** rendor në AMTP të shtetasit Artan Hazbi është e njëjta me atë që ndodhet në z. k. *** dhe nr. pasurie ***; vërtetim nga Bashkia Konispol, datë 1.3.2011, për shtetasin Artan Hazbi, i cili është banor i kësaj bashkie dhe ka paguar taksat e tokës bujqësore për vitin 2010;

dh) mandatarkëtimin nr. ***, datë 1.3.2011, nga Bashkia Konispol, arkëtuar shuma 4,420 (katërmijë e katërqind e njëzetë) lekë për vitet 2009 – 2010, nga shtetasi Artan Hazbi;

e) Kontratën e Qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.3.2011, nënshkruar ndërmjet palës qiradhënëse R. H. dhe palës qiramarrëse Artan Hazbi, të tokës bujqësore të quajtur “****” me sip. 1,800 m², sipas AMTP-së, afati i kontratës 40 vjet, çmimi i qirasë 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë/vit;

ë) AMTP-në e familjes së z. R. H., gjithsej sip. 5,860 m² në Konispol, Sarandë, në të cilin evidentohet toka “arë” me sip. 1,800 m²;

f) Vërtetimin e datës 10.3.2011, nga Bashkia Konispol se parcela në z. k. *** dhe nr. 2 rendor në AMTP të shtetasit R. H. është e njëjta me atë që ndodhet në z. k. *** dhe nr. pasurie ***;

g) vërtetimin e datës 10.3.2011, nga Bashkia Konispol për shtetasin R. H., i cili është banor i kësaj bashkie dhe ka paguar taksat e tokës bujqësore për vitin 2010;

gj) mandatarkëtimin nr. ***, datë 1.3.2011, nga Bashkia Konispol, arkëtuar shuma 27,109 (njëzet e shtatë mijë e njëqind e nëntë) lekë për vitet 2009 – 2010, nga shtetasi R. H.;

h) shkresën me të dhënat e llogarisë në emër të z. Artan Hazbi në “Societe Generale Albania”, datë 11.3.2011, si dhe mandatdepozitimi në llogari të shumës 1,000 (një mijë) lekë;

i) dokumentin e datës 6.3.2011, nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit Vlorë për zbatimin e kriterëve bazë të VKM-së. Dokument projekti nr. *** për “mbjellje ullaht” me aplikues shtetasin Artan Hazbi dhe hartues projekti znj. V. L., pronësia nr. ***, z. k. ***, në Konispol, Sarandë;

j) dokument-projektin për ngritjen e 4.4 dynym ullahtë gjatë marsit të vitit 2011, aplikant Artan Hazbi, Konispol. Bashkëlidhur përshkrimi i territorit dhe preventiv për koston e ngritjes së sip. 0.44 ha/ullahtë, në shumën totale 608,560 (gjashtëqind e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë, nga e cila shuma prej 454,560 (katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekësh financohet nga fermeri ndërsa diferenca prej 154,000 (njëqind e pesëdhjetë e katër mijë) lekësh kërkohet nga fondi i programit për bujqësinë;

k) historikun e lëvizjeve të llogarisë në emër të z. Artan Hazbi gjatë periudhës 1.6.2011 – 22.2.2016, ku evidentohen transfertat e mbërritura në llogari nga Dega e Thesarit Tiranë, subvencion për mbjellje të reja. Në datën 17.10.2011, në shumën 107,300 (njëqind e shtatë mijë e treqind) lekë dhe në datën 30.11.2011, në shumën 45,700 (dyzet e pesë mijë e shtatëqind) lekë;

l) tabelën e shpenzimeve dhe të të ardhurave për 5.2 dynym/ullahte të fermerit Artan Hazbi, Bashkia Konispol, kultura “ullaht”, gjatë periudhës 2011 – 2014, nënshkruar nga agronomi Dh. Q., datë 18.3.2015. Sipas tabelës, për periudhën 2011-2012, nuk është realizuar fitim, por janë llogaritur vetëm shpenzime në shumën 135,200 (njëqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind) lekë

për vitin 2011 dhe në shumën 40,000 (dyzet mijë) lekë për vitin 2012, ndërsa është realizuar fitim *neto* për vitin 2013, në shumën 70,500 (shtatëdhjetë mijë e pesëqind) lekë dhe për vitin 2014, në shumën 190,000 (njëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë;

ll) tabelën e shpenzimeve dhe të të ardhurave për 0.5 ha/ullishte të fermerit Artan Hazbi, Bashkia Konispol, kultura “ullinj”, viti 2015, nënshkruar nga agronomi Dh. Q., datë 17.3.2016, sipas tabelës, për vitin 2015 është realizuar fitim në shumën totale 205,000 (dyqind e pesë mijë) lekë;

m) dëftesën tatimore, ku subjekti tregtar “****” me NIPT ***, nënshkruar nga z. A. G., blen nga pala shitëse Artan Hazbi, gjithsej ullinj në vlerën 321,300 (treqind e njëzet e një mijë e treqind) lekë, formulari i pranimit të aplikimit pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoria Rajonale Vlorë. Aplikimi i kryer në datën 11.3.2011 nga z. R. H. pranë Qarkut Vlorë, Sarandë. Bashkëlidhur praktika e plotë e aplikimit.

9.3 Konsideratat mbi këtë investimin të përfshira në analizën financiare:

- i. Subjekti përcjell me deklaratën *Vetting* Kontratën e Qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.3.2011, nënshkruar ndërmjet palës qiradhënëse R. H. dhe palës qiramarrëse Artan Hazbi, të tokës bujqësore të quajtur “****” me sip. 1,800 m², sipas AMTP-së. Afati i kontratës është 40 vjet me çmim qiraje në vlerën 50,000 lekë/vit. Subjekti deklaron në deklaratën *Vetting* dhe në pyetësin standard se realisht nuk ka pasur shkëmbime monetare midis vëllezërve. Në analizën e subjektit nuk është përfshirë as shpenzim dhe as e ardhur për këtë marrëdhënie kontraktuale duke u mbështetur në deklaratimet e subjektit dhe mosprovimin e kryerjes së pagesave të qirasë.
- ii. Subjekti përcjell dokument projektin për ngritjen e 4.4 dynym ullishte gjatë marsit të vitit 2011, aplikant Artan Hazbi, Konispol. Në këtë projekt përshkruhet territori dhe i bashkëlidhet preventiv për koston e ngritjes së 0.44 ha ullishte, në vlerën totale 608,560 (gjashtëqind e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë, nga e cila shuma prej 454,560 (katërqind e pesëdhjetë e katër mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekësh financohet nga fermeri, ndërsa diferenca prej 154,000 (njëqind e pesëdhjetë e katër mijë) lekësh kërkohet nga fondi i programit për bujqësinë. Vlera e investimit e përfshirë në analizën financiare është konsideruar sa më sipërpërmendur, në vlerën 608,560 (gjashtëqind e tetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë) lekë dhe provuar me dokumentacionin e mësipërm.
- iii. Vlera e subvencionimit e deklaruar nga subjekti provohet nga komunikimi shkresor me “OTP²² Bank”, ku është transferuar në llogarinë e subjektit vlera 153,000 (njëqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekë gjatë vitit 2011 dhe vlera 97,500 (nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë gjatë vitit 2012. Origjina e këtyre transfertave është nga Dega e Thesarit Tiranë, me përshkrimin “subvencion për mbjellje të reja”. Përkatesisht është transferuar në datën 17.10.2011 shuma 107,300 (njëqind e shtatë mijë e treqind) lekë dhe në datën 30.11.2011 shuma 45,700 (dyzet e pesë mijë e shtatëqind) lekë, vlera të cilat janë përfshirë në analizën financiare. Vlerat e tjera të të ardhurave nga shitja e ullinjve për vaj, të deklaruara nga subjekti, nuk janë konsideruar në analizë sepse nuk përcillet dokumentacion ligjor provues.

9.4 Për sa më sipër, lidhur me këtë pasuri, konstatohet se:

a) Të ardhurat nga subvencionet bujqësore në shumën 153,000 (njëqind e pesëdhjetë e tre mijë) lekë në vitin 2011, duket se janë përfituar në kundërshtim me ligjin nr. 9817, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, neni 7, sipas të cilit kriteret për përfituesit nga fondi i programit, në kuadër të politikave bujqësore janë: fermerët, grupet e fermerëve, personat fizikë apo juridikë, të cilët kanë veprimtari bujqësore ose veprimtari ekonomike të lidhur me të; personat fizikë apo juridikë, të cilët e ushtrojnë veprimtarinë në industrinë agro-ushqimore; personat fizikë apo juridikë, të cilët ofrojnë shërbime për veprimtari bujqësore dhe veprimtari të tjera rurale.

b) Subjekti ka kryer aplikimin pranë Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural), si dhe ka përfituar nga subvencionet shtetërore, në kundërshtim me nenin 7 të ligjit nr. 9817, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”.

²² Shkresë nr. ***, datë 30.12.2019, nga “OTP Bank”.

c) Subjekti duket se e ka kryer këtë veprimtari në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës, si dhe me funksionin e tij si prokuror.

ç) Duket se subjekti i rivlerësimit ka fshehur këtë veprimtari nga deklaratimet periodike vjetore, duke iu shmangur kështu kontrollit të ligjshmërisë.

d) Lidhur me të ardhurat e deklaruara nga shitja e prodhimtarisë bujqësore (ullinj) në shumën 685,500 (gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e pesëqind) lekë, subjekti ka paraqitur fatura shitjeje në shumën 321,300 (treqind e njëzet e një mijë e treqind) lekë, por ndërkohë nuk është i regjistruar si subjekt tregtar.

dh) Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë për Komisionin mbi ligjshmërinë e ushtrimit prej tij të kësaj veprimtarie, si dhe ligjshmërinë për përfitimin e të ardhurave.

e) Të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga kjo veprimtari deri në këtë moment nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni, në analizën financiare.

9.5 Në bazë të nenit 52, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

9.6 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegon: *“Në lidhje me përfitimin e 153,000 lekëve si subvencion për mbjelljet e reja sipas Komisionit është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9817, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”. Unë, duke pasur tokë bujqësore në pronësi dhe duke e investuar këtë tokë në fshat qthem fermer. Në bazë të këtij ligji fermerët e përfitojnë këtë subvencion. E kam deklaruar këtë veprimtari familjare në DPV dhe nuk kam kryer fshehje apo aktivitet në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Nga familja ime bujqësore (babai, nëna dhe unë si përfitues në bazë të ligjit nr. 7501, ‘Për Tokën’) në atë kohë vetëm unë isha gjallë dhe unë iu kam shërbyer vetë ullinjve. Më pas, në vitet 2014 e në vazhdim, më ka ndihmuar bashkëjetuesja dhe fëmijët. Meqë nevojat familjare për ullinj dhe vaj ulliri ne i plotësonim, pjesën e tepërt të prodhimit e bënim dhuratë, por dhe e shisnim siç mund të shesim një send që nuk na nevojitet më.*

... dokumentacioni provues i është paraqitur Komisionit nga ana ime dhe që janë disa fatura dore nga një subjekt që ka qenë dhe është i regjistruar në organin tatimor. Unë jam familje bujqësore, nuk jam i licencuar si subjekt tregtar. Nuk bëj dot autofaturë. Së bashku me familjen (bashkëjetuesen dhe fëmijët) volëm ullinjtë. Përfaqësuesi i subjektit tregtar më njuh vetëm mua sepse unë jam nga Konispoli dhe jam kryefamiljar, prandaj te dëftesa tatimore ka shënuar emrin tim”.

9.7 Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e gjetjeve për të cilat i kaloi barra e provës dhe se ai ka kryer veprime që çenojnë figurën e tij si prokuror.

10. Nga shoqëria “***” sh.p.k., Sarandë, me administrator z. A. P., sipas konfirmimit bankar të “Raiffeisen Bank”, më 29.12.2006, është **kaluar në llogarinë rrjedhëse të subjektit të rivlerësimit shuma 860,000** (tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë me përshkrimin “likuidim detyrimi”.

10.1 Subjekti deklaroi se kjo shumë i është kthyer tërësisht shoqërisë nëpërmjet po kësaj banke më 21.6.2007, si “kaluar gabim”.

10.2 Subjekti rivlerësimit, në vijim të shpjegimeve të tij, sqaron: *“Siç kam sqaruar edhe kur kam dhënë deklaratime në ILDKPKI për këtë fakt, shtetasin S. P. e kam mik familjar. Ai është babai i administratorit të kësaj firme z. A. P.. Në bisedë me shtetasin z. S. P. rastësisht kishte rënë fjala se unë doja të shkoja në Gjermani ato dite për një vizë. Ai më tha se donte të blinte një autoveturë të përdorur dhe unë i premtova që nëse do të shkoja do t’ia blija, por për këtë gjë duhet të më jepte lekët paraprakisht. Për arsye familjare unë nuk kam shkuar fare në Gjermani. Ndërkohë shtetasi S. P., më kishte dërguar nëpërmjet bankës shumën e sipërcituar, por pa më vënë në dijeni se ishte kryer kalimi. Për këtë shumë që ai më kishte kaluar, unë jam vënë në dijeni afër mesit të vitit 2007. Për këtë arsye edhe në formularin e deklaratimit të pasurisë për vitin 2006 nuk e kam pasqyruar këtë veprim. Në kohën që u vura në dijeni i ktheva përsëri përmes bankës shumën e sipërcituar shoqërisë ‘***’ sh.p.k. Sqaroj se kjo shumë e dërguar nuk*

është përdorur asnjëherë nga ana ime, thjesht ka qenë gjendje në llogarinë time nga data 29.12.2006 deri më 21.6.2007, pra ishte kaluar gabim. Të dyja këto veprime i kam pasqyruar në deklaratën e pasurisë për vitin 2007. Nuk kam pasur dhe nuk kam detyrime financiare as me z. S. P. as me “***” sh.p.k. dhe me asnjë individ, person tjetër fizik apo juridik”.

10.3 Nga hetimi i llogarive në “Raiffeisen Bank”²³ të subjektit rezultoi se më 29.12.2006 është kaluar me transfertë nga shoqëria “***” sh.p.k., vlera 860,000 (tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë dhe me përshkrimin “likuidim detyrimi”. Më tej, subjekti i ka kaluar këto fonde në një llogari depozitë. Në datën 21.6.2007, subjekti ka kryer kalimin e vlerës te shoqëria “***” sh.p.k., me përshkrimin “kaluar gabim nga ‘Prella’ sh.p.k.”, duke përdorur fondet nga prishja e depozitës që kishte në këtë bankë.

10.4 Për këtë pasuri rezultoi se:

a) Subjekti nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2006 transfertën nga shoqëria “***” sh.p.k., në vlerën 860,000 (tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë dhe qëllimin e përdorimit të saj, duke e fshehur këtë veprim e duke iu shmangur kontrollit mbi ligjshmërinë.

b) Deklarimet e subjektit “për mospasjen dijeni të këtij veprimi” në llogarinë e tij, nuk janë bindëse për Komisionin pasi ai vetë, me prezencën e tij, ka çelur llogari depozite me këto fonde.

10.5 Në bazë të nenit 52, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

10.6 Në vijim të rezultateve të hetimit subjekti shpjegon: “Nuk kam pasur dijeni për këtë kalim që është bërë më 29.12.2006. Deri në momentin e plotësimit të DPV-së për këtë vit, pra, deri më 31.3.2007, nuk dija gjë për këtë kalim. Me sa më kujtohet kam pasur dy llogari në ‘Raiffesien Bank’ dhe i kam sistemuar llogaritë. Nuk e kam përdorur këtë shumë të hollash. Ajo ka qenë gjendje në bankë. E kam kthyer kur u vura në dijeni në vitin 2007 pa e përdorur. Nuk kam bërë fshehje”.

10.7 Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti nuk arriti të bindte trupin gjykues për të kundërtën e gjetjeve për të cilat i kaloi barra e provës. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë në deklarin periodik vjetor, duke fshehur këtë transfertë dhe qëllimin e kryerjes së saj, nga hetimi dhe kontrolli që kryente ILDKPKI-ja.

24. Deklarimi i personit të lidhur, znj. V. H (bashkëjetueses së subjektit të rivlerësimit) – subjekti ka deklaruar se ka filluar të bashkëjetojë me znj. V. H prej vitit 2014 dhe nga marrëdhënia e tyre, më 19.8.2009, ka lindur vajza A. H..

1. Apartament banimi me sipërfaqe 60.47 m², sh. ***, kati ***, ap. ***, lagjja “***”, Lushnjë, pasuria me nr. ***, z. k. ***. Kontrata e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.11.2013, para noterit A. K., në Lushnjë dhe regjistrimi në ZVRPP-në Lushnjë apo vërtetimi nga dokumenti hipotekor, datë 22.11.2013. Kjo shumë është deklaruar e likuiduar deri më 22.1.2007. Vlera: 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë. Pjesa takuese: 100%.

1.1 Në deklaratën e pasurisë, bashkëjetuesja deklaron si burim për pasurinë e mësipërme: “Blerë me kursimet e mia dhe të familjes, kursime nga puna ime para martese, dhurata nga prindërit e mi, kursime gjatë martesës, kursime nga puna ime pas martese, si e ve, etj.”.

1.2 ASHK²⁴-ja Lushnjë konfirmon se shtetasja V. H., ka të regjistruar pasurinë apartament me sip. 60.47 m², me nr. ***, z. k. ***, e përcjellë me Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.11.2013, nënshkruar ndërmjet palës shitëse “***” sh.p.k. dhe palës blerëse V. H.. Vërtetim/dokumentet hipotekor, datë 12.8.2010, ku figuron e regjistruar pasuria nr. ***, lloji “apartament”, me sip. 60.47 m², në emër të shoqërisë “***” sh.p.k. Kjo pasuri është rivlerësuar në vitin 2017, në vlerën 3,400,000 (tre milionë e katërqind mijë) lekë dhe është shitur me Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.12.2018, në vlerën totale 3,400,000 (tre milionë e katërqind mijë) lekë [(apartamenti në vlerën 2,424,847 (dy milionë e katërqind e

²³ Shihni shkresën nr. ***, datë 27.2.2020, nga Raiffeisen Invest.

²⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2020.

njëzetë e katër mijë e tetëqind e dyzetë e shtatë) lekë dhe mobilet, etj., në vlerën 976,000 (nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë].

1.3 Lidhur me çmimin e blerjes së apartamentit, nga hetimi i Komisionit, ka rezultuar se:

a) Personi lidhur me subjektin, znj. V. H., në deklaratën *Vetting*, deklaron se shuma prej 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekësh është likuiduar prej saj deri më 22.1.2007, duke përcjellë Kontratën e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.11.2013, nënshkruar ndërmjet palës shitëse shoqëria “****” sh.p.k. dhe palës blerëse V. H., të apartamentit me sip. 60,47 m², regjistruar me nr. ***, ndodhur në Lushnjë. Në kontratë citohet se çmimi i shitjes së apartamentit në vlerën 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, është likuiduar në datën 22.1.2007, jashtë zyrës noteriale.

b) DPPPP-ja²⁵ konfirmon se shtetasja V. H (bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit), në datën 11.11.2013²⁶ ka blerë një apartament me çmim të deklaruar në vlerën 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë nga pala shitëse shoqëria “****” sh.p.k., me NIPT ***. DPPPP-ja ka nga “General Societe Albania”, dokumentin mandatdepozitim të shumës 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, datë 9.12.2013, nga shtetasja V. H në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. me përshkrim “likuidim përfundimtar blerje apartamenti”. Bashkëlidhur letërnjoftimi ID i znj. V. H., si dhe Kontrata e Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.11.2013.

c) Nga verifikimi i veprimeve bankare konfirmohet se në datën 9.12.2013 në “Societe Generale Albania” (aktualisht “OTP Bank”) është kryer transaksioni bankar nga shtetasja V. H në vlerën 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë, me përshkrim “derdhje *cash* në lekë”, burimi i të ardhurave: ndërtime konstruksionesh të tjera.

1.4 Komisioni e krahasoi çmimin e deklaruar për blerjen e këtij apartamenti me referencën nga EKB-ja²⁷ për vitet 2007 dhe 2013.

a) Në vitin 2007 çmimi i shitjes së apartamenteve në tregun e lirë, në qytetin e Lushnjës, rezulton të jetë sipas referencës së EKB-së në vlerën 40,529 lekë/m² dhe çmimi total i apartamentit nëse do të ishte blerë në këtë periudhë do të ishte në vlerën 2,450,789 (dy milionë e katërqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë ose 1,63 herë më i lartë se çmimi i deklaruar nga personi i lidhur me subjektin.

b) Në vitin 2013 çmimi i shitjes së apartamenteve në tregun e lirë, në qytetin e Lushnjës rezulton të jetë sipas referencës së EKB-së në vlerën 43,500 lekë/m² dhe çmimi total i apartamentit nëse do të ishte blerë në këtë periudhë do të ishte në vlerën 2,630,445 (dy milion gjashtëdhjetë mijë e katërqind e dyzetë e pesë) lekë ose 1,75 herë më i lartë se çmimi i deklaruar nga personi i lidhur me subjektin.

1.5 Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, bashkëjetuesja ka deklaruar në deklaratën *Vetting* se kjo pronë është krijuar me të ardhurat e saj para bashkëjetesës (*blerë me kursimet e mia dhe të familjes, kursime nga puna ime para martesë, dhurata nga prindërit e mi, kursime gjatë martesës, kursime nga puna ime pas martesë, si e ve, etj.*).

1.6 Në përfundim, lidhur me këtë pasuri, rezulton sa vijon:

a) Duket se pagesa për blerjen e apartamentit në Lushnjë nuk është kryer deri më 22.1.2007, por më 11.11.2013. Duket se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në deklaratën *Vetting*.

b) Duket se bashkëjetuesja e subjektit është favorizuar në blerjen e një apartamenti me çmim më të ulët se sa çmimi i referencës së EKB-së ose çmimi i deklaruar prej saj në vlerën 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë është fiktiv. Ky apartament është shitur në vitin 2018, në vlerën totale 3,400,000 (tre milionë e katërqind mijë) lekë [(apartamenti në vlerën 2,424,847 (dy milionë e katërqind e njëzetë e katër mijë e tetëqind e dyzetë e shtatë) lekë dhe mobilet, etj., në vlerën 976,000 (nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë]. Subjekti dhe bashkëjetuesja (personi i lidhur) nuk kanë deklaruar shpenzime shtesë për këtë pasuri ndër vite.

²⁵ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2017, në dosjen e ILDKPKI-së (aneks ***.)

²⁶ Sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., të nënshkruar para noter A. K..

²⁷ Shihni udhëzimin nr. ***, datë 4.4.2007 dhe udhëzimin nr. ***, datë 8.5.2013.

c) Subjekti rivlerësimi duhet të provojë burimin e ligjshëm për krijim e kësaj pasurie në vitin 2013 (apo për të ardhurat e derdhura *cash* në bankë), si dhe investimet e tjera të kryera të cilat kanë rritur logjikisht vlerën e pasurisë.

1.7 Në bazë të nenit 52, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

1.8 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegon: “Ky veprim është fiktiv dhe nuk është kryer nga bashkëjetuesja ime, pasi ajo i ka dhënë paraprakisht të gjitha lekët, që kur pallati ishte në themele, në gropë dhe për këtë arsye ka përfutuar edhe ulje çmimi nga çmimi përfundimtar i shitjes. Pasi u vumë në dijeni me rezultatet e hetimit administrativ për mua subjektin Artan Hazbi, ku është përmendur edhe mandati i depozitimit, datë 9.12.2013, në emër të bashkëjetueses sime V. H., kjo e fundit i bëri kërkesë me shkrim ‘OTP Bank’, për të marrë kopjen e këtij mandatar-këtimit. Nga ‘OTP Bank’ është vënë në dispozicion dokumentacioni i kërkuar që është fotokopje e njehsuar me origjinalin (me vulën e njomë). Ky material, modele të lira, si dhe dorëshkrime të bashkëjetueses (modele eksperimentale) iu vunë në dispozicion Shoqatës së Shkencave Ligjore, Qendrës së Kërkimeve dhe Ekspertimeve Kriminalistike, Tiranë, m kryetar Dr. E. M., me qëllim kryerjen e ekspertimit grafik. Pas kryerjes së ekspertimit u arrit në konkluzionin se shkrimi dhe nënshkrimi i bërë në rekuizitën e emrit dhe mbiemrit ‘V. H.’ dhe poshtë tij nuk janë bere nga shtetasja V. H.. Ky konkluzion është kategorik. Po paraqesim aktin e ekspertimit grafik të shkrimit dhe nënshkrimit.

Nëse kontrata përfundimtare për shitjen e apartamentit është bërë më 11.11.2013 përse duhej bërë pagesa më 9.12.2013. Komisioni gabimisht ka arritur në konkluzionin se likuidimi i shumës 1,500,000 lekë është bërë më 11.11.2013 kur mandatpagesën e ka në datën 9.12.2013. Si mund të bëhej kontrata në datën 11.11.2013 dhe të citohej se të gjitha lekët janë dhënë deri më 22.01.2007?! Nuk ka asnjë logjike që subjekti ‘***’ sh.p.k. të bënte kontratën përfundimtare pa i marrë lekët. Në praktikën e përditshme ndeshen raste kur klientët porositës i kanë dhënë të gjitha lekët dhe subjektet nuk ju bëjnë kontratat, por i zvarrisin pambarimisht për t’ju marrë të ardhura “të fshehura”, por në asnjë rast e kundërta. Subjekti thotë që i mora lekët që në vitin 2007, zvarrit, kthen për përpilimin e kontratës deri më 11.11.2013. Bën kontratën që është likuiduar totalisht, pastaj deklaron rreth një muaj më vonë se i janë derdhur në llogarite e tij 1,500,000 leke!!! Ose duhet pranuar kontrata që thotë se shuma totale 1,500,000 lekë për blerjen e këtij apartamenti është likuiduar jashtë zyrës noteriale deri në datën 22.1.2007 ose duhet pranuar data e mandatpagesës së fundit më 9.12.2013. Me prova shkencore vërtetohet që emri, mbiemri dhe nënshkrimi i V. H. te ky mandatpagesë nuk janë të sajat, pra, rrjedhimisht nuk ka derdhur në formë “cash” shumën prej 1,500,000 lekësh, por duhet të ketë qenë ndonjë person tjetër i interesuar. Kjo derdhje dyshojmë se mund të jetë bërë nga shoqëria ‘***’ sh. a. për të rregulluar gjendjen e llogarisë së firmës. Kur në kontratën e shitblerjes së pasurisë, datë 11.11.201, është pasqyruar likuidimi total i shumës 1,500,000 lekë deri në datën 22.1.2007 përse duhet të blinte për herë të dytë më 9.12.2013 të njëjtin apartament bashkëjetuesja ime?! Në këto kushte nuk ka deklarim të rreme apo fshehje të pasurisë. Burimi ka qenë i ligjshëm dhe i provuar. Pasuria është blerë në atë shumë që është shënuar në kontratë. Çmimi nuk është fiktiv sepse është kryer pagesë e shpejtë, që në themele, para se sa të ndërtohej apartamenti dhe në këto kushte çmimi patjetër që do të ishte më i ulët. Rivlerësimi është bërë sipas vlerës së përcaktuar VKM-së në vitin përkatës.

Në lidhje me këtë falsifikim që është bërë nga punonjësja e bankës apo persona të tjerë në praninë e saj, bashkëjetuesja ime V. H në datën 9.4.2021 ka depozituar kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat”.

1.9 Subjekti përcjell si provë mandatpagesën nr. ***, datë 23.9.2006, në të cilën rezulton se nga shtetasja V. H është bërë derdhja *cash* e shumës 1,000,000 (një milion) lekë për pagesë të pjeshme për apartament banimi në favor të shoqërisë ‘****’ sh.p.k. e nënshkruar nga z. A. K.. Gjithashtu, subjekti përcjell aktekspertimin grafik të nënshkrimit të znj. V. H të hartuar nga Shoqata e Shkencave Ligjore në datën 2.4.2021 dhe kallëzimin penal kundër punonjësës së ‘OTP Bank’, me objekt falsifikim dokumentesh.

1.10 Në vijim, trupi gjykues ka vlerësuar të mos përfshijë në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit rezultatin e hetimit lidhur me këtë pasuri, për sa kohë kjo çështje është duke u trajtuar nga një organ tjetër (momenti i pagimit të shumës për blerjen e apartamentit, viti 2007 apo 2013), duke lënë të pavlerësuar edhe burimin për krijimin e kësaj pasurie, si dhe vlerëson të mos e përfshijë këtë pasuri në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit.

Trupi gjykues nuk ka vlerësuar të nevojshme pezullimin e procesit të rivlerësimit për subjektin Artan Hazbi, deri në zgjidhjen e kësaj çështjeje nga organi kompetent, apo zgjidhjen lidhur me pretendimet e subjektit, pasi vlerëson se provat e tjera kanë arritur nivelin e provueshmërisë dhe se mospërfshirja e kësaj pasurie në vlerësimin e subjektit nuk ndryshon rezultatin e hetimit administrativ të arritur nga Komisioni, në mënyrë të tillë, që të ndikojë në vendimmarrjen përfundimtare.

2. Autoveturë tip “Mercedes-Benz” C220 CDI, vit prodhimi 2004, me targa *, regjistruar në DRSHTRR-në Sarandë, blerë në vlerën 780,000 (shtatëqind e tetëdhjetë mijë) lekë, e zhdoganuar nga ish-pronari, me Kontratë Shitje Automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.1.2012, lidhur para noterit I. H., Shijak. Pjesa takuese: 100%.**

2.1 DPSHTRRja²⁸konfirmon automjet me targa ***, në pronësi të shtetases V. H.. Bashkëlidhur ndodhet Kontratë Shitje Automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 24.1.2012, nënshkruar ndërmjet palës shitëse B. B. dhe palës blerëse V. H., të automjetit tip “Daimler Chrysler”, kundrejt vlerës 780,000 lekë, jashtë zyrës së noterit.

2.2 Znj. V. H., në deklaratën *Vetting* deklaron si burim: blerë me kursimet e saj dhe të familjes, dhurata nga prindërit, kursime nga puna para, gjatë dhe pas martesës, si e ve, etj.

2.3 Gjatë hetimit të Komisionit²⁹, subjekti përgjigjet se: *“Vlera e kursimeve e deklaruar në deklaratën Vetting (2,460,000 lekë), nuk vazhdon të jetë gjendje kursimesh cash, pasi është përdorur nga bashkëjetuesja e tij, ndër vite, përpara se sa ai të fillonte bashkëjetesën. Pjesërisht kjo vlerë sipas bashkëjetueses së tij është përdorur për blerjen e një autoveturë tip “Mercedes Benz”, me targa ***, në vitin 2012, për blerjen e disa krerë lopë në vitin 2013, kurse pjesa tjetër është përdorur për konsum nga bashkëjetuesja dhe fëmijët para fillimit të bashkëjetesës sonë”.*

2.4 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se kjo pasuri është krijuar para deklarimit të bashkëjetesës dhe se znj. V. H nuk ka qenë subjekt deklarues. Nga hetimet e Komisionit ka rezultuar se prindërit e saj kanë përfituar të ardhura si ish të përndjekur politikë edhe se ajo vetë, gjithashtu, ka pasur të ardhura financiare të ligjshme nga puna e saj. Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar të mos përfshijë këtë pasuri të personit të lidhur në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit.

3. Aktiviteti i mbarështimit të lopëve. Bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit deklaron në deklaratën *Vetting* aktivitetin e mbarështimi të 25 krerë/lopë, blerë në datën 31.12.2012, në shumën 400,000 (katërqind mijë) lekë, sipas Kontratës së Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., lidhur përpara noterit publik. Kjo pasuri është regjistruar në Drejtorinë e Bujqësisë Sarandë. Nga Drejtoria e Shërbimit Pyjor Sarandë është lidhur edhe Kontrata e Qirasë nr. ***, datë 12.8.2013, për marrjen me qira për kullotje dhe kositje bari të një sipërfaqeje 35 ha, me afat 3 vjet. Nga mbarështimi i 25 krerë/lopë, deri më 31.12.2015, janë krijuar të ardhura *neto*: në vitin 2013 në vlerën 294,000 (dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë; në vitin 2014 në vlerën 1,248,000 (një milion e dyqind e dyzetë e tetë mijë) lekë; dhe në vitin 2015 në vlerën 704,000 (shtatëqind e katër mijë) lekë.

3.1 Subjekti përcjell me deklaratën *Vetting* dokumentacionin në vijim:

a) Kontratë shitje prone livadheve për kullotë e kositje bari, nënshkruar ndërmjet palës qiradhënëse Drejtoria e Shërbimit Pyjor Sarandë dhe palës qiramarrëse V. H.. Qiradhënësi i jep me qira për kullotje qiramarrësit V. H., kullotën që ndodhet në ekonominë kullimore A. M., në parcelën nr. ***, me sip. 35 ha, sipas vendimit nr. ***, datë 2.8.2013, të DSHP-së, me afat

²⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.1.2020.

²⁹ Shihni përgjigjen nr. 1, pyetësori, datë 22.1.2021.

3-vjeçar. Qiraja vjetore është përlogaritur në vlerën 12,500 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë.

b) Vërtetim nga Dega e Bujqësisë Sarandë, Zyra Veterinare, datë 17.3.2015, për znj. V. H., e cila ka një fermë blegtorale dhe mbarështon në fermën e saj 25 krerë/gjedh.

c) Vërtetim nga Dega e Bujqësisë Sarandë, Zyra Veterinare, datë 17.3.2016, për znj. V. H., e cila ka një fermë blegtorale dhe mbarështon në fermën e saj 24 krerë lopë/gjedh.

d) Planbiznes i fermës me pronare znj. V. H., nënshkruar nga specialisti i blegtorisë B. M., sipas të cilit të ardhurat janë (fitimi i realizuar): për vitin 2013 në vlerën 294,000 (dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë) lekë; për vitin 2014 në vlerën 1,248,000 (një milion e dyqind e dyzetë e tetë mijë) lekë; dhe për vitin 2015 në vlerën 704,000 (shtatëqind e katër mijë) lekë.

3.2 Në deklaratën e pasurisë *Vetting*, personi lidhur nuk deklarohen burim për pasurinë e mësipërme. Gjatë hetimit të Komisionit³⁰, subjekti përgjigjet se *vlera e kursimeve e deklaruar në deklaratën Vetting prej 2,460,000 lekësh, nuk vazhdon të jetë gjendje kursimesh cash, pasi është përdorur nga bashkëjetuesja e tij, ndër vite, përpara se sa të fillonte bashkëjetesën. Pjesërisht kjo vlerë sipas bashkëjetueses së tij është përdorur për blerjen e një autoveture tip "Mercedes-Benz", me targa ***, në vitin 2012, për blerjen e disa krerë/lopë në vitin 2013, kurse pjesa tjetër është përdorur për konsum nga bashkëjetuesja dhe fëmijët para fillimit të bashkëjetesës sonë.*

3.3 Subjekti, i pyetur³¹ nga Komisioni, në lidhje me konfliktin e interesave të bashkëjetueses, shpjegon se *këtë kontratë qiraje znj. V. H e ka bërë përpara se sa ne të jetonim bashkë në një shtëpi, pra, para bashkëjetesës. Siç kam përmendur më sipër bashkëjetesa ime ka filluar në mesin e viti 2014. Kur kam mësuar hollësitë për këtë kontratë nga bashkëjetuesja i kam kukuar asaj për të zgjidhur kontratën. Ajo ka nxjerrë menjëherë fermën në shitje. Fillimisht nuk ka pasur blerës dhe në fund të vitit 2015 kur efektivisht u gjet një blerës, u shit "de facto" ferma dhe u hoq dorë nga zbatimi i kësaj kontrate qiraje për vitin 2016, pa kërkuar as shumën e paguar për këtë vit.*

3.4 Të ardhura *neto* të krijuara nga shitja e pasurisë së luajtshme (bagëti), sipas Kontratës së Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.8.2016, lidhur përpara noterit publik në vlerën 2,415,000 (dy milionë e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë, pasi janë shitur 25 krerë/lopë dhe 18 viçat e tyre, të cilat blerësi i ka marrë në dorëzim në datën 1.1.2016 dhe pagesën e ka bërë me tri këste të barabarta në fund të muajve gusht, shtator dhe tetor të vitit 2016. Një pjesë e lekëve të fituara nga shitja e bagëtive dhe, konkretisht, vlera prej 2,400,000 (dy milionë e katërqind mijë) lekësh është investuar nga znj. V. H., te Fondi i Investimit në "Raiffeisen Bank", në datën 30.11.2016, me një afat 1-vjeçar për blerje kuotash.

3.5 Deklarimin e parë, znj. V. H., e ka bërë në DPV-në e vitit 2014, ku deklaroi: *"25 krerë/lopë. Blerë me kursimet e mia para bashkëjetese në vlerën 400,000 lekë. Kontrata nr. *** rep., nr. *** kol., notere L. T., Sarandë. Mbarëstim lopësh. Vlera rreth 1,248,000 lekë"*.

3.6 Në lidhje me shitjen e pasurisë së luajtshme (bagëti), subjekti përcjell Kontratën e Shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.8.2016, me çmim shitje 2,415,000 (dy milionë e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë, për shitjen e 25 krerë lopëve (1,875,000 lekë) dhe 18 krerë viça (540,000 lekë), kundrejt vlerës totale 2,415,000 (dy milionë e katërqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë. Në kontratë është parashikuar edhe mënyra e shlyerjes së çmimit të blerjes. Kjo vlerë do të shlyhet nga blerësi me këste bankare në vlerën 805,000 (tetëqind e pesë mijë) lekë secili, në llogarinë bankare të shitëses në "Raiffeisen Bank": kësti i parë më 30.8.2016; kësti i dytë më 30.9.2016; si dhe kësti i tretë më 30.10.2016.

3.7 Nga hetimi i llogarive bankare në "Raiffeisen Bank"³² të znj. V. H., transaksionet në vlera dhe data përputhen me ato të parashikuara në kontratën e shitjes.

3.8 Lidhur me të ardhurat nga shitja e "krerë gjedhë" në vlerën rreth 2,015,000 (dy milionë e pesëmbëdhjetë mijë) lekë, rezulton se në vitin 2012 janë blerë 25 krerë/lopë, në vlerën 400,000

³⁰ Shihni përgjigjen nr. 1, pyetësori, datë 22.1.2021.

³¹ Shihni përgjigjen nr. 6, pyetësori, datë 12.7.2020.

³² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 27.2.2020, nga "Raiffeisen Bank".

(katërqind mijë) lekë ose 16,000 lekë/për krerë. Ndërsa, 4 vjet më pas, në vitin 2016, janë shitur 25 krerë/lopë, në vlerën 1,875,000 (një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë ose 75,000 lekë/për krerë, rreth 4,69 herë më shtrenjtë sesa blerja. Pra, duket e dyshimtë shitja e tyre me vlerë shumë më të lartë sesa çmimi i blerjes rreth 4,69 herë.

3.9 Nga komunikimi me DPT-në³³ dhe QKB-në³⁴ nuk rezulton që bashkëjetuesja të jetë e regjistruar për kryerjen e këtij aktiviteti, si dhe nuk rezulton as informacion mbi pagesën e detyrimeve përkatëse për diferencën e çmimit të shitjes së aktivitetit të mësipërm me koston e ngritjes së këtij aktiviteti. Komisioni nuk i ka përfshirë në analizë këto të ardhura nga shitja e aktivitetit, deri në këto momente.

3.10 Në përfundim për këtë pasuri rezulton se:

a) Bashkëjetuesja e subjekti të rivlerësimit deklaroi se burim krijimi për këtë aktivitet kanë shërbyer të ardhurat nga kursimet e saj, të cilat janë dhuruar nga prindërit para bashkëjetesës. Ajo nuk ka mundur të provojë se të ardhurat e pretenduara kanë burimin nga dëmshpërblimi si ish i përndjekur politik të përfituara nga prindërit e saj.

b) Lidhur me Kontratën e Qirasë, datë 12.8.2013, me afat 3-vjeçar, për dhënien e kullotave dhe livadheve për kullotë e kositje bari, me qiradhënës Drejtorinë e Shërbimit Pyjor Sarandë dhe qiramarrëse V. H., rezulton se:

i) Referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, në pikën 1, të nenin 21, përcaktohet se: *“Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët dhe prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik”*. Në nenin 24 përcaktohet: *“Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin, në zbatim të ndalimeve të përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 9367, i cili përbëhet nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es”*.

ii) Në interpretim të neneve të sipërcituara rezulton se prokurori pranë gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit, si dhe rrethi i personave të lidhur me ta, nuk mund të lidhin kontrata me institucione publike.

iii) Një ndalim i tillë është përcaktuar me ligjin nr. 44/2014, datë 24.4.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” të ndryshuar. Ky ligj ka hyrë në fuqi në datën 3.6.2014.

iv) Sipas ndryshimeve ligjore, rezulton se çdo kontratë e lidhur me institucione publike nga data 3.6.2014 është në shkelje të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

v) Bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit, pas datës 3.6.2014, duhet të kishte marrë të gjitha masat e nevojshme për të zgjidhur situatën e konfliktit të interesave.

c) Duket se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe legjisllacionin në fuqi.

3.11 Në bazë të nenit 52, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

3.12 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegon: *“Të ardhurat janë të ligjshme, pasi janë përfituara nga dëmshpërblimi për të përndjekurit politike, janë tërhequr në kohë të ndryshme në formë cash, janë dhënë në po të njëjtën formë, janë mbajtur dhe përdorur nga V. H po ashtu. Në kushtet kur kontrata e qirasë për kullotat ishte trevjeçare dhe ishte lidhur në datën 12.8.2013, pra, përpara datës 3.6.2014 kur hyri në fuqi ligji për, “Parandalimin e konfliktit të interesit...”, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me konflikt të interesit. Kjo kontratë nuk është rinovuar, më pas kësaj date, kur u krijua mundësia ferma e lopëve u shit dhe nuk kam ushtruar veprimtari në kushtet e konfliktit të interesit”*.

³³ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 6.1.2020.

³⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 13.1.2020.

3.13 Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës së dërguar nga Komisioni për këtë pasuri të bashkëjetueses së tij e se ajo ka vepruar në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe legjislationin në fuqi. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të bashkëjetueses, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e pretenduara me burim nga dëmshpërblimi për ish të përndjekurit politikë, janë të ligjshme, por se nuk provohet në asnjë formë se të ardhurat e pretenduara janë, pikërisht, me burim nga dëmshpërblimi, duke krijuar kështu bindjen se nuk justifikojnë krijimin e kësaj pasurie me burime të ligjshme.

4. Të ardhura për periudhën 2014 – nëntor 2016, në vlerën 2,464,996 (dy milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë. Në deklaratën *Vetting*, bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit deklaroi: *“Të ardhurat neto, nga puna si avokate në Dhomën e Avokatisë Lushnjë për periudhën 2014 – nëntor 2016, janë në vlerën 2,464,996 lekë”*.

4.1 DRT-ja³⁵ Fier konfirmon se shtetasja V. H është e regjistruar si Person Fizik me NIPT L34614402M, datë 14.10.2013, me objekt “aktivitete të drejtësisë”.

4.2 QKB-ja³⁶ konfirmon aktivitet tregtar në emër të shtetasës V. H regjistruar si Person Fizik me NIPT L34614402M. Bashkëlidhur ndodhet ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “Vabona Hila”, Person Fizik, regjistruar në datën 14.10.2013, aktivitet “avokate” dhe me vend ushtrimi të aktivitetit në Lushnjë.

4.3 Nga Komisioni, në analizën financiare janë përfshirë vlerat e mësipërme të të ardhurave të deklaruara nga aktiviteti “avokate”, për periudhën 2014 – 2016 dhe të konfirmuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier.

5. Gjendje cash jashtë sistemit bankar, që disponon bashkëjetuesja në deklarinimin *Vetting*, është në vlerën 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekë dhe të ardhura të krijuara nga dhurata të prindërve në vlerën 2,460,000 (dy milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, në vitet 2010, 2011 dhe 2013. Burimi i krijimit: dhuratë nga prindërit, të cilët i kanë përfituar këto lekë nga dëmshpërblimi për ish të përndjekurit politikë. Nuk ka deklaruar më parë hollësi për këtë dhuratë sepse i është dhënë përpara bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit Artan Hazbi.

5.1 Lidhur me burimin e krijimit të gjendjes së kursimeve, bashkëjetuesja përcjell në deklaratën *Vetting*, Deklaratën³⁷ Noteriale, datë 23.1.2017, të nënshkruar nga z. F. H. (babai i saj), i cili deklaroi se për shkak të statusit të tij si ish i përndjekur politik ka përfutur dëmshpërblim, në tri këste: vlerën 956,342 (nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e dyzetë e dy) lekë në datën 2.6.2010; vlerën 538,000 (pesëqind e tridhjetë e tetë mijë) lekë në datën 27.4.2011; si dhe vlerën 956,000 (nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë në datën 10.5.2013. Z. F. H. deklaroi se shumën 2,459,975 (dy milion e katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë të tërhequr nga “Union Bank”, ia ka dhuruar vajzës V. H..

5.2 Nga dokumentacioni i përcjellë në Komision nga “Union Bank”³⁸, rezulton se z. F. H. i janë transferuar në llogarinë e tij: shuma 961,041 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyzetë e një) lekë në datën 1.6.2010; shuma 538,125 (pesëqind e tridhjetë e tetë mijë e njëqind e njëzetë e pesë) lekë në datën 13.4.2011; si dhe shuma 961,041 ((nëntëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyzetë e një) lekë në datën 3.5.2013, me përshkrimet “dëmshpërblim për të përndjekurit politik”. Këto vlera janë tërhequr të gjitha nga shtetasi F. H..

5.3 Në deklaratën vjetore të vitit 2014 (deklarimi i saj i parë), bashkëjetuesja deklaroi: *“Kam kursyer gjatë gjithë jetës sime, nga puna para martesë, gjatë martesë, si e ve, në bashkëjetesë, si dhe nga aktiviteti im ekonomik (mbarështim lopësh), vlerën rreth 1,400,000 lekë, të cila i kam një pjesë cash dhe në bankë”*.

5.4 Komisioni, në përfundim të sa më sipër, konstatoi se:

³⁵ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 6.1.2020, të DPT-së.

³⁶ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 13.1.2020, të QKB-së.

³⁷ Shihni deklaratën noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.1.2017 (aneks 4/15), në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 30.12.2019.

- a) Nuk provohet në ndonjë mënyrë dhënia e shumave nga babai i bashkëjetueses V. H., pasi ato janë tërhequr nga llogaria bankare. Duket e dyshimtë përse këto shuma nuk janë transferuar nga llogaria e z. F. H. te llogaria bankare e vajzës, por janë tërhequr të gjitha *cash*.
- b) Bashkëjetuesja në deklaratimet e saj (DPV-në e vitit 2014 dhe në deklaratën *Vetting*) nuk mban të njëjtin qëndrim në lidhje me burimin e krijimit të gjendjes *cash*, duke e ndryshuar atë në deklaratën *Vetting*, çka nuk provon se çfarë ka ndodhur realisht deri në vitin 2014.
- c) Deri në këto momente këto të ardhura nuk janë përfshirë në analizën financiare, pasi subjekti i rivlerësimit (personi lidhur me të) duhet të provojë se burimi i kursimeve kanë qenë këto të ardhura.

5.5 Në bazë të nenit 52, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

5.6 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegon: *“Burimi i krijimit të gjendjes cash vërtetohet me dokumentet e bankës (tërheqje nga z. F. H.), deklaratën noteriale të tij, deklaratën noteriale të L. H. etj. Pandemia e COVID-19, në Shqipëri, por edhe në botë, tregoi se nëse nuk mban gjendje likuiditetesh në formë cash jashtë sistemit bankar për situata emergjente je i vdekur. Këto të ardhura duhet të përfshihen në analizën financiare, pasi janë nga burim i ligjshëm. Mendoj se quhet burim i ligjshëm veprimi i tërheqjes së lekëve që është kryer në bankë. Nuk ka shkelje ligji që anëtarët e të njëjtit trung familjar të bien në marrëveshje dhe të shkëmbejnë lekë cash me njeri-tjetrin, pasi ato u tërhoqën nga banka dhe do të përdoreshin nga njeri prej anëtareve të trungut familjar, në këtë rast znj. V. H.. Po ashtu, nuk ndalohet mbajtja e likuiditeteve në formë cash më shumë se 1,500,000 lekë në vit. Vërtetohet se brenda një viti bashkëjetuesja ime V. H nuk ka mbajtur më tepër se 1 1,500,000 lekë edhe përpara bashkëjetesës me mua”.*

5.7 Në përfundim, trupi gjykues nuk u bind për të kundërtën e rezultatit të hetimit e subjekti nuk mundi të paraqesë prova bindëse për Komisionin. Deklaratat noteriale të prindërve të lëshuara në janar të vitit 2017 vijnë për efekt të procesit të rivlerësimit dhe nuk mund të kenë ndonjë vlerë provuese në kohë. Gjithashtu, deklaratimet e znj. V. H në vitin 2014 nuk i referohen burimit të të ardhurave nga dëmshpërblimi i prindërve të saj. Veprimet bankare, lidhur me vlerat e përfituara nga dëmshpërblimi, janë tërheqje të menjëhershme *cash* dhe nuk mund të japin ndonjë të dhënë se këto të ardhura i kanë kaluar znj. V. H.. Trupi gjykues, në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga hetimi, nuk mundi të krijojë ndonjë lidhje dhe, për pasojë, bindjen se shumata *cash* të deklaruara nga bashkëjetuesja e subjektit të rivlerësimit janë me burim nga dëmshpërblimi i prindërve përfitur në vitet 2010, 2011 dhe 2013 dhe, për pasojë, vlerëson se ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting*.

25. GJETJE TË TJERA

1. **Ndërtesë dhe truall në Ksamil** (investim në ndërtimin e një hoteli). Subjekti deklaron në DPV-në e vitit 2018, veprime të tjera juridike me pasuritë e tij, të kryera pas deklaratës *Vetting*, si vijon: Me Kontratën e Shkëmbimit nr. *** rep., nr.*** kol., datë 4.10.2018, lidhur para noterit publik G. N., në Sarandë, ka shkëmbyer një apartament banimi me sip.77 m², ballkone 11.4 m² dhe sip. përbashkët 4 m² (pjesërisht të mobiluar), të ndodhur në Sarandë, lagja nr. ***, ap. *** z. k. ***, nr. ***, të deklaruar më parë dhe të rivlerësuar më parë në vlerën 65,065 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e pesë) euro në pronësinë të subjektit 100 % me pasurinë truall 403 m², brenda të cilit një ndërtesë karabina dhe mur tulle (e papërfunduar) me sip. 156 m² nga të cilat sip. banimi 80 m² dhe ambient social-ekonomik 76 m² që ndodhet në Ksamil, z. k. ***, nr. *** pasurie, rivlerësuar në vlerën 8,502,080 (tetë milionë e pesëqind e dy mijë e tetëdhjetë) lekë, në pronësi të z. T. X. Për këtë objekt është kërkuar dhe miratuar leje për sheshndërtim.

1.2 Subjekti, gjatë hetimit në lidhje me investimin në ndërtimin e një hoteli në Ksamil, shpjegon³⁹ se: *“Në vitin 2018, kam shkëmbyer shtëpinë time të banimit në lagjen nr. ***, Sarandë, me një objekt njëkatësh të legalizuar, por të papërfunduar. Pas kësaj kam aplikuar*

³⁹ Shihni pyetësorin standard përgjigja nr. 20; pyetësor datë 27.1.2021, përgjigja nr. 9 dhe nr. 10.

për lejendërtimi në Bashkinë Sarandë. Pas marrjes së lejes së zhvillimit në truallin prej 403 m², për ndërtim të një sipërfaqeje ndërtimore 403 m², në total duke përfshirë edhe ndërtimin ekzistues, pra, me koeficient ndërtimi 1, kam marrë kredi pranë 'Fibank' në shumën 16,000,000 lekë. Ndërkohë, bashkëjetuesja ime ka shitur shtëpinë e saj në Lushnjë së bashku me mobilet. Me shumën e kredisë, me shumën e marrë nga shitja e banesës së bashkëjetueses, si dhe me kursimet që kemi pasur të dy kemi filluar ndërtimin që ende nuk ka përfunduar. Sipas dokumentacionit toka dhe objekti janë në pronësinë time, por të bllokuara nga 'Fibank' për shkak të kredisë”.

1.3 Subjekti, me shpjegimet e tij, përcjell: Kontratën e Shkëmbimit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.10.2018, me palë shtetasit T. X dhe Artan Hazbi, ku janë shkëmbyer një apartament banimi me sip. 77 m² me pasurinë truall me sip. 403 m², brenda të cilit një ndërtesë karabina dhe mur tulle (e papërfunduar) me sip. 156 m² nga të cilat sip. banimi 80 m² dhe ambient social-ekonomik me sip. 76 m², Ksamil; Faturë Tatimore Shitje me vlerë 2,161,276 (dy milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, për pagesë ndaj shoqërisë “****” sh.p.k. dhe blerës Artan Hazbi; mandatpagesë në “Raiffeisen Bank”; Certifikatë Pronësie për pasurinë truall me sip. 403 m² dhe ndërtesë me sip. 156 m², në Ksamil, me pronar z. Artan Hazbi.

1.4 ASHK⁴⁰-ja Sarandë konfirmon veprimet e mësipërme të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit. Përcillet Kontrata e Shkëmbimit (pasuri e paluajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.10.2018, në të cilën parashikohet shkëmbimi i pasurisë apartament me sip. 77 m², në Sarandë, lagjja nr. *** , z. k. *** , i rivlerësuar në vlerën 65,065 (gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëdhjetë e pesë) euro⁴¹, me pasurinë truall me sip. 403 m² nga kjo, ndërtesë 156 m² (nga të cilat sip. banimi 80 m², ambient social-ekonomik me sip. 76 m², sip. bazë 156 m²), që ndodhet në Ksamil, Sarandë, z. k. *** , nr. pasurie *** , e cila është rivlerësuar në vlerën 8,502,080 (tetë milionë e pesëqind e dy mijë e tetëdhjetë) lekë.

1.5 Vlerësimi i pronës truall dhe sip. ndërtesë 156 m², në Ksamil, është në shumën e rivlerësuar prej 8,502,080 (tetë milionë e pesëqind e dy mijë e tetëdhjetë) lekësh, më i ulët se vlerësimi i apartamentit me sip. 77 m², në Sarandë.

1.6 Subjekti, i pyetur për lidhjen e tij me shtetasin T. X dhe për mënyrën e fitimit të pronësisë së pasurisë truall dhe ndërtesë njëkatëshe, në Ksamil, shpjegon se: “Me shtetasin T. X dhe familjen e tij kam miqësi të hershme. Ai e ka fituar pronësinë me lejelegalizimi”.

1.7 Nga ASHK-ja⁴² përcillet edhe dokumentacioni i fitimit të pasurisë nga shtetasi T. X, sipas të cilit rezulton se pasuria është fituar me procedurat e legalizimit të nisura nga ky shtetas, i cili e ka vetëdeklaruar në datën 8.9.2006, si ndërtim të kryer në vitin 2005. Trualli me sip. 403 m² është blerë me Kontratë Kalimi të Pronësisë të Parcelës Ndërtimore nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.10.2010, me palë shitëse ALUIZNI Vlorë dhe palë blerëse T. X me bono privatizimi në vlerën 857,764 (tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e shtatëdhjetë e gjashtëdhjetë e katër) lekë.

1.8 Lidhur me koston e ndërtimit të investimit, hotel në Ksamil, subjekti nuk ka përcjellë kosto totale dhe situacion punimesh të kryera.

1.9 Në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë, nga deklaratimet e subjektit, kanë shërbyer: (a) kredi në “Fibank”, në vlerën 16,000,000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë; (b) bashkëjetuesja ka shitur apartamentin e saj në Lushnjë së bashku me mobilet, në vlerën 3,400,000 (tre milionë e katërqind mijë) lekë; si dhe (c) kursimet e tyre.

1.10 Shkresa përcjell nga “Fibank”⁴³ (ose Banka e Parë e Investime) konfirmon se subjekti i vlerësimit dhe znj. V. H kanë lidhur Kontratë Kredie nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.2.2020, me notere O. D. në vlerën 16,000,000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë, me qëllim “mbulimin e shpenzimeve për përfundimin e punimeve për ndërtimin e kateve shtesë, si dhe mobilimin e tyre”. Fondet e kredisë janë përdorur për shlyerje faturash, situacionesh ndërtimi për shoqërinë

⁴⁰ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 8.2.2021 dhe praktikën e ASHK-së të përcjella në Komision.

⁴¹ Vlera e konvertuar nga Komisioni rezulton të jetë 8,650,392 lekë.

⁴² Shihni shkresën nr. *** prot., datë 1.3.2021.

⁴³ Shihni shkresën nr. *** , datë 5.3.2021.

“****” sh.p.k. dhe janë kaluar me transfertë bankare. Kredia është lëvruar sipas tri transheve, si vijon: (i) transhi i parë në vlerën 7,000,000 (shtatë milionë) lekë parashikuar brenda shkurtit të vitit 2020; (ii) transhi i dytë në vlerën 6,000,000 (gjashtë milionë) lekë parashikuar brenda prillit të vitit 2020; (iii) transhi i tretë në vlerën 3,000,000 (tre milionë) lekë parashikuar brenda majit të vitit 2020.

1.11 Bashkëjetuesja deklaron në DPV-në e vitit 2018 shitjen e apartamentit me sip. 60.47 m² dhe mobilet e tij, në Lushnjë, në vlerën 3,400,000 lekë [apartamenti në vlerën 2,424,847 ((dy milionë e katërqind e njëzetë e katër mijë e tetëqind e dyzetë e shtatë) lekë dhe mobilet, etj., në vlerën 976,000 ((nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) lekë], sipas Kontratës së Shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.12.2018 dhe Deklaratës Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 27.12.2018, lidhur përpara noteres Sh. S., në Lushnjë, me palë blerëse E. Gj.. Apartamenti është rivlerësuar në vitin 2017 dhe është deklaruar në DPV-në e vitit 2017 nga bashkëjetuesja e subjektit në vlerën 2,430,000 (dy milionë e katërqind e tridhjetë) lekë. Gjithashtu, deklarohet se vlerat e mësipërme janë derdhur në llogarinë në “Raiffeisen Bank”. Nga hetimi i llogarive të bashkëjetueses në “Raiffeisen Bank”, rezulton se vlerat e mësipërme janë derdhur në këtë llogari në datën 31.12.2019, të cilat më pas janë investuar nga znj. V. H., në Fondin e Raiffeisen Invest.

1.12 Në përfundim, të sa më sipër, rezulton se:

a) Kjo pasuri është krijuar pas deklaratës *Vetting*, por për krijim e saj janë përdorur të ardhura të krijuara gjatë periudhës së rivlerësimit për të cilat nuk provohet burimi i ligjshëm i tyre. Të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Lushnjë të personit të lidhur, deri në këtë moment, nuk janë të provuara sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, po ashtu burimi i përdorur për krijimin e kësaj pasurie është ende i paprovuar.

b) Të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e kursimeve rezultojnë sipas analizës financiare me bilanc negativ, deri në këtë moment.

c) Mbetet i dyshimtë shkëmbimi mes dy pasurive, referuar edhe marrëdhënies mes palëve të rezultuar gjatë hetimit.

d) Duket se subjekti rivlerësimit ka vepruar si investitor dhe biznesmen në ushtrimin e kësaj veprimtarie, prandaj duhet të shpjegojë bindshëm për Komisionin a bie ndesh kjo veprimtari me ushtrimin aktualisht të detyrës së prokurorit të Republikës së Shqipërisë.

1.13 Në bazë të nenit 52, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

1.14 Në vijim të barrës së provës, subjekti shpjegon: *“Komisioni nuk ka llogaritur si shpenzime për krijimin e pasurisë vlerën prej rreth 2,240,000 lekësh që unë i kam pasur në Fondin e Investimeve të “Raiffeisen Bank” dhe i kam tërhequr për t’i përdorur në këtë ndërtim. Pra, të ardhurat për krijimin e kësaj pasurie janë të ligjshme. Edhe aktiviteti im si investitor është në përputhje me Kushtetutën. Mendoj se nëse do të kisha dy shtëpi dhe do ta jepja njërin me qira nuk do të quhesha biznesmen. Identik duhet të jetë edhe rasti i një subjekti (A. K.), që në dijeninë time ka dhënë me përqindje toke truall në pronësi të tij dhe me pas pjesën takuese (disa apartamente banimi ndoshta edhe njësi tregtare) i ka dhënë me qira, disa prej tyre i ka shitur dhe kjo gjë nuk është quajtur veprimtari në kundërshtim me ushtrimin e detyrës si prokuror i Republikës prandaj dhe KPA ka vendosur rikonfirmim në detyrë të tij”*.

1.15 Në përfundim, trupi gjykues i Komisionit vlerëson se kjo është një pasuri e krijuar pas deklaratës *Vetting* dhe, si e tillë, duhet të kontrollohet dhe të verifikohet lidhur me ligjshmërinë e saj nga organet kompetente, pa dashur të zëvendësojë ato në ushtrimin e funksioneve të tyre, si dhe duke konsideruar gjetjet e Komisionit, deri në këtë fazë, të mjaftueshme për marrjen e një vendimi përfundimtar lidhur me rivlerësimin e subjektit Artan Hazbi.

2. Apartament në Tiranë, kompleksi “*****”, Kthesa e Kamzës, pallatet ***, e shtetasit R. H.. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaron këtë pasuri si adresë banimi në të cilën jeton pa qira.

2.1 Subjekti i rivlerësimit deklaron për herë të parë në DPV-në e vitit 2010, si adresë tjetër banimi: “Kompleksi “*****”, Kthesa e Kamzës, blloku ***, ap. ***. Tiranë”.

2.2 I pyetur⁴⁴ nga Komisioni, për mosdeklarimin e përdorimit të këtij apartamenti në deklaratën veting, ai përgjigjet: *“Në lidhje me deklarimin si adresë banimi të këtij apartamenti nga ana ime, kjo gjë është bërë në një nga rubrikat e deklaratave periodike për vitin 2014, sepse atëherë fillova të banoj efektivisht në këtë adresë. Përderisa e kam deklaruar si adresë banimi (banoj pa qira...) në deklaratën Vetting kam menduar se kjo gjë ishte e mjaftueshme për faktin se pronar i apartamentit nuk jam unë”*.

2.3 ASHK-ja nuk konfirmon apartament në pronësi të shtetasve R. H. ose Artan Hazbi, në Tiranë. Subjekti⁴⁵ shpjegon se apartamenti nuk është regjistruar ende në ASHK dhe nuk është nënshkruar kontrata e shitjes e se në dijeninë e tij ky pallat nuk është i regjistruar ende në regjistrat hipotekorë.

2.4 Subjekti deklaron se kjo pasuri është blerë nga vëllai R. H., duke përcjellë në deklaratën Vetting edhe Deklaratën Noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.10.2016, nënshkruar nga deklaruesit R. dhe Artan Hazbi, ku deklarohet se shtetasi R. H. ka prenotuar për blerje një apartament banimi me nr. ***, me sip. 94.15 m², në kompleksin “****”, Kthesa e Kamzës, Tiranë, i cili është përfunduar, por i paregjistruar në ZVRPP-në Tiranë, ndërsa shtetasi Artan Hazbi ka në pronësi një banesë dhe truall, regjistruar me nr.***, në Konispol, Sarandë, të trashëguar nga prindërit. Gjithashtu, deklarohet se i kanë lënë njëri-tjetrit në përdorim, pa kundërshpërbllim që prej datës së lidhjes së kontratës së prenotimit për blerje të apartamentit dhe që nga viti 2010 për banesën dhe truallin në Konispol.

2.5 Subjekti, i pyetur nga Komisioni⁴⁶, në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit nga vëllai, shpjegon se: *“ Vëllai im R. H. që në vitin 1990, ka qenë emigrant, fillimisht duke kaluar nga mali, pasi banon në Konispol, në kufi me Greqinë. Ka punuar në Athinë dhe ka sjellë të ardhura. Ka ikur përsëri me vizë në vitin 1993. Nga viti 1998 kur ka marrë një vizë greke me afat qëndrimi 100 ditë deri në vitin 2020, vëllai im R. H. ka pasur lejeqëndrimi dhe punë në shtetin grek. Ka punuar në punë të ndryshme si hidraulik, elektrikist, murator, punëtor në bujqësi, në blegtori, në peshkim etj. Ka punuar edhe në dy punë në të njëjtën ditë dhe ka fjetur në apotheke për banesa për punëtorët pa qira dhe duke e mbajtur me ushqim pronari. Bashkëshortja e tij ka punuar në punë bujqësie në Konispol. Me kursimet e lekëve të fituara nga puna e tij dhe familjes dhe ekonomia familjare ka siguruar të ardhurat për blerjen e këtij apartamenti. Vetëm nga puna vetëm tek një pronar grek shtetasin G. P. për periudhën 1998 – 2010, ka përfutur rreth 91,000 euro ose ekuivalentin e tyre. Sa më sipër, vërtetohet me kopje pasaporte shqiptare për jashtë shtetit me viza greke me lejeqëndrimi greke, me librin e shëndetit, me deklaratën e shtetasit G. P.”*.

2.6 Subjekti, për të provuar mundësinë e blerjes së apartamentit me të ardhura të ligjshme nga vëllai R. H., ka përcjellë me shpjegimet e mësipërme dokumentacionin, si vijon:

- Librezë Personale Shëndetësore e të Siguruarit të lëshuar nga Organi i Sigurimeve Shoqërore Bujqësore në shtetin grek e vlefshme për periudhën 30.10.2000 – 31.12.2020.
- Fotokopje të faqes së pasaportave të tij (të reja dhe të vjetra), ku është pajisur me vizë greke dhe lejeqëndrimi për periudhat 21.2.1994 – 21.2.1995; 18.4.1995 – 18.4.1996; 6.3.1998 – 6.7.1998; 12.11.1998 – 12.3.1999 dhe 28.11.2004 – 23.7.2020.
- Deklaratë nga shtetasi grek G. P. e lëshuar në datën 5.3.2020, në të cilën deklaron se z. R. H. ka qenë i punësuar në aktivitete bujqësore në Komunën Sagiada të Bashkisë Filiales nga viti 1998 – 2010 me pagë 7,000 (shtatë mijë) euro/vit ose në total 91,000 (nëntëdhjetë mijë) euro, i regjistruar me nr. tatimor *** dhe nr. regjistri shëndetësor ***.

2.7 Komisioni hetoi mbi të ardhurat e mundshme të shtetasit R. H. në shtetin shqiptar, nga ku nuk rezultuan të ardhura të fituara prej tij, sipas shkresave të përcjella nga DPT, QKB, ISSH dhe ISSH arkiv.

2.8 Duket se shtetasi R. H. ka qenë i punësuar në shtetin grek dhe i regjistruar me nr. tatimor, por nuk përcillet informacion mbi vlerën e të ardhurave të realizuara në këtë shtet.

⁴⁴ Shihni përgjigjen nr. 7, pyetësor datë 12.7.2020.

⁴⁵ Shihni përgjigjen e pyetësor datë 27.1.2021.

⁴⁶ Shihni përgjigjen nr. 7, pyetësor datë 12.07.2020.

2.9 Për sa më sipër, për këtë pasuri rezulton se:

- a) Subjekti nuk ka deklaruar apartamentin në përdorim në emër të vëllait, në rubrikën përkatëse të deklaratës *Vetting*, por e ka deklaruar si adresë banimi.
- b) Prokura e Posaçme e nënshkruar në Lushnjë dhe Kontrata e Porosisë e nënshkruar në Tiranë janë hartuar në të njëjtën datë 24.12.2008. Duket e dyshimtë përse z. R. H. nuk arriti të firmoste vetë kontratën e porosisë, meqenëse ndodhej në Lushnjë dhe përse u përfaqësua nga vëllai Artan Hazbi.
- c) Duket e dyshimtë përse shtetasja N. B. arriti të blinte këtë pasuri në datën 19.12.2008 nga shtetasi R. A. dhe vetëm 5 ditë më pas ia shet këtë pasuri vëllait të subjektit R. H., përfaqësuar nga subjekti i rivlerësimit. Nuk kuptohet qëllimi i blerjes së apartamentit nga shtetasja N. B., e cila e shiti 5 ditë më pas, ndërkohë që nuk kishte shlyer ende detyrimin ndaj shtetasit R. A..
- d) Gjatë hetimit, subjekti deklaroi se ka filluar të jetojë në këtë apartament gjatë vitit 2014, ndërsa e deklaroi si adresë banimi që në DPV-në e vitit 2010.
- e) Nuk kuptohet qëllimi i blerjes së apartamentit nga vëllai i subjektit R. H. në vitin 2009, kur prej asaj kohe dhe në vazhdim aty jeton subjekti Artan Hazbi pa asnjë kompensim financiar ndaj tij, ndërkohë që vëllai dhe familja jetojnë mes Greqisë dhe Konispolit.
- f) Nuk arrihet të provohet aftësia paguese e vëllait të subjektit, z. R. H..
- g) Nuk arrihet të provohet se shuma prej 54,000 (pesëdhjetë e katër mijë) euro është dhënë nga vëllai R. H. te subjekti Artan Hazbi për pagesën e apartamentit.
- h) Shuma e blerjes së apartamentit prej 54,000 (pesëdhjetë e katër mijë) euro deklarohet se është shlyer *cash*, në një vlerë të plotë, e gjitha në datën e nënshkrimit të Kontratës së Porosisë ndaj shtetasit N. B., ndërkohë që kjo e fundit ka pasur detyrime të palikuiduara ndaj shtetasit R. A. për këtë pasuri të blerë 5 ditë më parë.
- i) Në vijim të sa më sipër, ngrihen dyshime se pasuria e mësipërme mund të jetë pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit.

2.10 Në bazë të nenit 52, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

2.11 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegon: *“Këtë apartament e kam deklaruar në përdorim në kohën që efektivisht kam banuar në të. Adresë tjetër kam shënuar edhe në Sarandë në apartamentin që vet kisha blere por që nuk kam fjetur asnjë ditë në të. Pra, nuk ka lidhje se sa adresa kam deklaruar dhe do të deklaroj, por ku kam banuar efektivisht.*

Vëllai im R. H. në lidhje me këtë apartament banimi kishte mësuar nga njerëzit e bashkëshortes së tij se ishte një rast i mirë. Ai erdhi nga Saranda me makinë dhe do të kthehej përsëri brenda të njëjtës dite. Më takoi mua në Lushnjë. Kishte vendosur ta blinte apartamentin prandaj bëri prokurën në Lushnjë. Erdhi në Tiranë së bashku me mua. Ai i dha lekët (euro) pronares N. B. në kohën që unë po shikoja apartamentin dhe u rikthye po atë natë në Konispol në banesën e tij sepse kishte punë, i duhej të shkonte përsëri për në Greqi. Duke qenë se ai i dha leket dhe mua më kishte bërë prokurë, unë qëndrova për të bërë dokumentet.

Nga sa kam marre vesh me vonë znj. B. nuk i ka dhënë lekë për tri apartamente në të njëjtin pallat z. A., pasi kanë pasur një marrëdhënie bashkëpunimi mes tyre. Ajo i ka shitur menjëherë këto tri apartamente për shkak të një prone që donte të përfitonte brenda dhjetorit të vitit 2008.”

Vëllai e bleu këtë apartament si çdo person që do të ketë në Tiranë një shtëpi, me qëllim që ta kishte për fëmijët për shkollën e lartë, si dhe me pas nëse ndonjë nga fëmijët do të qëndronte në Tiranë të kishte shtëpinë e vet. Në vitin 2010 dhe më pas kur djali i tij E. H. ka vazhduar studimet në Tiranë ka banuar në këtë apartament. Me pas, ai është punësuar në Konispol, Sarandë dhe unë u futa të banoj edhe si garanci për shkak të ndjekjes së procedurave të regjistrimit të pronës sepse ka probleme midis N. B. dhe R. A., pasi ajo nuk i ka shlyer detyrimet këtij të fundit për këtë dhe dy banesa të tjera në këtë pallat, ndërsa ai ka tentuar t'i marrë forcërisht ato por ka hasur në rezistencën e pronareve aktuale përfshirë edhe në rezistencën time.

Unë nuk jetoj që nga viti 2008 në këtë apartament por siç kam shpjeguar që nga mesi i vitit 2014. Po është e vërtetë që nuk paguaj qira por i kisha lënë në përdorim edhe unë vëllait në Konispol banesën time, token time, pemët rreth e qark banesës etj. Për këtë gjë ka deklaruar edhe vëllai dhe deklaratën e keni. Dua të bëj të ditur se vetëm nga hardhitë e rrushit që kam rreth e qark banesës sime në Konispol janë prodhuar që në kohën që prindërit ishin gjallë dhe prodhohen edhe sot më tepër se 300 (treqind) litër raki që ka vlere nga 120,000 deri në 150,000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Të ardhurat e vëllait janë të ligjshme. Në dijeninë time ai ka paguar të gjitha detyrimet ndaj shtetit grek sepse nëse nuk do të paguante detyrimet nuk do t'i rinovonin lejeqëndrimet. Nuk kemi mundësi objektive të vërtetojmë një fakt të tillë sot në kushtet kur vëllai ka ndërruar jete. Nuk ka fshehje apo deklaram të rremë”.

2.12 Subjekti përcjell me shpjegimet e tij: kopje të diplomës së djalit të vëllait E. H., i cili në periudhën 2010 – 2014 ka qenë student në Tiranë; deklaratë të shtetasës A. H.; deklaratë të djalit E. H.; si dhe certifikatën e vdekje të vëllait R. H.. Në deklaratë shprehen se apartamenti është blerë në vitin 2008 nga babai me të ardhurat nga punësimi në Greqi, nga puna e nënës në bujqësi etj. Pas vitit 2014, ky apartament është përdorur nga nipi i subjektit gjatë kohës që ka ndjekur shkollën dhe, më pas, deklarojnë se ka banuar subjekti.

2.13 Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e gjetjeve, për të cilat i kaloi barra e provës. Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë lidhur me këtë pasuri. Ai nuk mundi të provojë mundësitë financiare me të ardhura të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie. Trupi gjykues krijoi bindjen se nëpërmjet veprimeve të njëpasnjëshme lidhur me blerjen e kësaj pasurie, ka pasur përpjekje për fshehjen e të vërtetës lidhur me këtë pasuri duke e konsideruar pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit.

3. ASHK⁴⁷-ja përcjell Kontratë Blerje nr. * rep., nr. *** kol., datë 5.11.200, me palë blerëse Artan Hazbi dhe palë shitëse shtetasit N. C. dhe I. C. të pasurisë truall me sip. 277 m² kundrejt shumës 277,000 (dyqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë) lekë. Gjithashtu, përcillet edhe Kontrata e Shitjes së Truallit nr. *** rep., nr. *** kol., datë 8.11.2002, me palë shitëse Artan Hazbi dhe palë blerëse M. V., kundrejt shumës 400,000 (katërqind mijë) lekë.**

3.1 Me shkresën e ASHK-së përcillet edhe dokumentacioni ligjor i blerjes së truallit me sip. 277 m² nga shtetasi N. C. me palë shitëse Bashkinë Sarandë. Blerja e truallit është nënshkruar në datën 29.10.2002, kundrejt vlerës 132,960 (njëqind e tridhjetë e dy mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) lekë. Me vendim të datës 16.9.1999, Bashkia Sarandë ka miratuar lejen e sheshndërtimit, blloku nr. ***, parcela ***, me sip. 277 m², për objekt 2-3 kate mbi tokë, për shtetasin N. C. si investitor. Në datën 12.9.2000 është mbajtur procesverbali i piketimit të objektit, parcela nr. ***, ***, me investitor N. C.. Në datën 8.10.2002 është miratuar leja e ndërtimit me vendimin nr. ***, datë 30.9.2002, të KRRT-së, për “banesë ***, ***, Turizëm, ****”, financuar nga shtetasi N. C..

3.2 Në përfundim të sa më sipër rezulton:

- a) Duket se subjekti e ka shitur truallin e mësipërm, vetëm 3 ditë më pas nga dita e blerjes, 1,44 herë më shumë se çmimi i blerjes.
- b) Subjekti nuk i ka deklaruar veprimet juridike të mësipërme në deklaratën para fillimit të detyrës dhe as në deklaratën *Vetting*.
- c) Gjithashtu, nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore për të ardhurën e realizuar nga këto veprime juridike (400,000 lekë – 277,000 lekë).
- d) Duket e dyshimtë dhe e paqartë arsyeja e blerjes së truallit nga subjekti i rivlerësimit dhe shitja 3 ditë më pas, ndërkohë, që shitja mund të realizohej nga pronari i parë (N. C.).
- e) Duket se subjekti i rivlerësimit vepron si biznesmen dhe jo si prokuror.

3.3 Në bazë të nenit 52, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

⁴⁷ Shihni shkresat nr. *** prot., datë 9.8.2017, datë 11.10.2017 dhe nr. *** Prot., datë 9.10.2017 (dosja ILDKPKI, aneks ***) dhe shkresën nr. *** prot., datë 8.2.2021, në dosjen e Komisionit.

3.4 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegon: *“Ky truall është blerë nga ana ime në vitin 2002 dhe është shitur pas disa ditësh, po në këtë vit, pak më shtrenjtë. Nuk e kam deklaruar se fillimisht në vitin 2004 kur kam plotësuar formularin e parë sepse nuk kishte rubrikë ku duhej deklaruar ndërsa në deklaratën Vetting e kisha harruar fare si transaksion. Mu dha rasti për ta blerë. Mendova të ndërtoja shtëpinë sepse ishte në një vend më i mirë se trualli që unë kisha përfituar vet dhe se aty kalonte edhe rruga për të çuar materiale ndërtimi. Nuk kisha lekë për ta ndërtuar. Mendova të marr kredi. Në kohën që po bëhesha gati për të marrë kredi më doli një i njohur që kishte ardhur nga Greqia dhe kërkonte të blinte sheshndërtimi. Ia shita atij sepse në atë kohë unë isha beqar, nuk i kisha lekët për ndërtim, si dhe kisha marrë edhe vet një shesh tjetër ndërtimi. Me sa mbaj mend hipoteka në atë kohë ma ka mbajtur tatimin mbi të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie. Edhe sot hipoteka është agjent i mbajtës se tatimit mbi shitjet e pasurisë së paluajtshme, kështu që lekët të këtij tatimi mi ka mbajtur hipoteka pasi unë kam shitur si qytetar, si individ jo si subjekt tregtar. Nuk kam fshehur, por kam harruar të deklaroj në deklaratën Vetting”.*

3.5 Në përfundim, Komisioni konstatoi se subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e gjetjeve, për të cilat i kaloi barra e provës. Subjekti ka bërë deklaram të pasaktë, ka mungesë të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie dhe se nuk ka paguar detyrimet tatimore për buxhetin e shtetit lidhur me të ardhurat e përfituara nga transaksioni i kryer.

26. ANALIZA FINANCIARE

26.1 Lidhur me pasuritë e krijuara, shpenzimet dhe kursimet e deklaruara u verifikuan dhe u krahasuan përputhshmëria e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave pasurore private/vjetore, deklaratën “Vetting”, si dhe në aktet e tjera në dosjen e Komisionit.

26.2 Njësia e Shërbimit Ligjor përgatiti analizën financiare për subjektin e rivlerësimit, ku për periudhën 2003 – 2016, rezulton me mungesë burimesh financiare në vlerën negative prej 5,724,914 (pesë milionë e shtatëqind e njëzetë e katër mijë e nëntëqind e katërmbëdhjetë) lekësh (kursimet e bashkëjetueses nuk janë konsideruar në analizë deri në këtë moment).

26.3 Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

26.4 Në vijim të rezultateve të hetimit, subjekti shpjegon si vijon: *“Pavarësisht se të dy prindërit kanë qenë me pensione pleqërie ato nuk janë llogaritur kur vetëm nëna ime e ndjerë ka përfituar rreth 1,000,000 lekë duke u trajtuar me gjysmë pensioni. Babait i bie të ketë përfituar pension pleqërie dyfishin e saj sepse e përfitonte të plotë atë si pension pleqërie punëtor në shtet. Ngaqë nuk janë llogaritur të dy pensionet e pleqërisë se prindërve të mi gabimisht është nxjerrë balanca negative për blerjen e banesës në vitin 1995 nga EKB-ja Sarandë. Tre persona në përbërje familjare, dy me pensione dhe një në pune (unë) patjetër që kishim kursime në një vit më shumë se 72,000 lekë. Kjo pa llogaritur faktin që veç pensioneve prindërit e mi kishin edhe ekonomi ndihmëse familjare.*

Duke pasur shtëpi në fshat, tokë truall, ku mbillen perimet dimërore dhe verore, tokë arë e pemëtoze, si dhe duke pasur bagëti të imëta, shpendë shtëpiakë, pemë, park bletësh (pra, duke pasur mish, qumësht dhe nënprodukte të tij, si djathë, gjizë, salcë kosi, gjalpë, vezë, ullinj, vaj ulliri, mjaltë, fruta, perime) etj., asgjë nga këto nuk është llogaritur.

Nuk është llogaritur si e ardhur shitja e autoveturës sime për vlerën 250,000 lekë në vitin 2006, që mendoj se e kam pasur gjendje edhe në vitin 2007 kur është blerë apartamenti i banimit në Sarandë. Po ashtu, në atë vit të ardhurat nga pensioni i nënës time kanë qenë afërsisht 100,000 lekë dhe nuk del balanca negative me rreth 330,000 lekë, siç e keni llogaritur Ju (po paraqes si provë bashkëlidhur kontratën e shitblerjes së autoveturës, datë 24.1.2006).

Nuk janë llogaritur 1,100,000 lekët e tërhequra nga ana ime në vitin 2012 nga banka dhe që besoj se mund ‘ti kem pasur gjendje “cash” edhe në vitin 2013 dhe në këto kushte kam dalë me balancë negative rreth 1,200,000 lekë në këtë vit.

Për disa vite më janë llogaritur gabimisht si shpenzime udhëtimi nga rreth 90,000 lekë çdo vit kur unë nuk i kam pasur këto shpenzime. Nuk janë llogaritur, gjithashtu, edhe të ardhurat e krijuara nga shitja e ullinjve. Nuk janë llogaritur kursimet e bashkëjetueses para, gjatë dhe pas martesës së saj dhe ato para fillimit të bashkëjetueses me mua. Nuk janë llogaritur të ardhurat e përfituara nga dhurata, ndër vite, e prindërve për bashkëshorten nga dëmshpërblimi për të përndjekurit politikë, rreth 2,400,000 lekë. Nuk janë llogaritur të ardhurat nga punësimi në subjektin "Isak" sh.p.k., në shumën neto prej rreth 510,000 lekësh. Nuk janë llogaritur të ardhurat e pensionit ushqimor për fëmijën Kejvin Hila në total rreth 700,000 lekë për gjithë periudhën. Nuk janë llogaritur të ardhurat e krijuara nga shitja e qumështit dhe mishit në fermën e lopëve në vitet 2014 dhe 2015, rreth 1,800,000 lekë".

26.5 Lidhur me vlerën e tërhequr në vitin 2012 prej 1,200,000 (një milion e dyqind mijë) lekësh dhe pretendimin e subjektit se duhej konsideruar si gjendje *cash* në vitin 2013, kjo nuk është pranuar nga Komisioni, pasi nuk është deklaruar në DPV-të përkatëse, ajo është vendosur si shpenzim në vitin 2012. Lidhur me shumën e përfitur nga shitja e automjetit në vitin 2006 dhe pretendimin e subjektit se duhej mbartur në vitin 2007, si kursim nga viti pararendës, nuk është pranuar nga Komisioni, për sa kohë nuk është deklaruar si gjendje *cash* në DPV-të përkatëse.

26.6 Lidhur me të ardhurat nga shitja e ullinjve, nga shitja e qumështit dhe mishit në fermën e lopëve në vitet 2014 dhe 2015, nuk janë marrë në konsideratë dhe janë arsytuar më lartë në këtë vendim. Të ardhurat e bashkëjetueses para vitit 2017 nuk janë marrë në konsideratë, pasi nuk janë përfshirë as shpenzimet e kryera prej saj para bashkëjetesës. Lidhur me të ardhurat për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar me burim nga dëmshpërblimi si ish i përndjekur politik për babanë e znj. V. H., janë shpjeguar më lart në vendim se trupi gjykues ka vendosur të mos e pranojë si burim financiar për krijim e gjendjes *cash* së deklaruar.

26.7 Në përfundim, duke marrë në konsideratë në analizën financiare edhe të ardhurat nga pensioni i nënës së subjektit (periudha 2003 – 2010), të cilat janë në vlerën 670,303 (gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e treqind e tre) lekë, rezultati financiar do të ndryshojë në vlerën prej -5,547,482 (pesë milionë e pesëqind e dyzetë e shtatë mijë e katërqind e tetëdhjetë e dy) lekësh.

27. Në përfundim të vlerësimit për kriterin e pasurisë, pas vlerësimit të rezultateve të hetimit në raport me shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në vijim të barrës së provës, si dhe vlerësimit të situatës faktike, nëpërmjet analizës dhe çmuarjes së provave të administruara gjatë hetimit dhe akteve të administruara në vijim të barrës së provës, si dhe dëgjimit të subjektit të rivlerësimit në seancën dëgjimore publike, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, trupi gjykues i Komisionit arriti në konkluzionin se provat për kriterin e pasurisë kanë nivelin e provueshmërisë dhe se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit për një pjesë të madhe të tyre. Trupi gjykues i vlerëson këto konkluzione si të mjaftueshme për të arritur në përfundimin, lidhur me kontrollin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të dhe, si pasojë, ndaj tij duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

28. Në këto kushte, trupi gjykues e çmoi të panevojshëm analizimin e disa prej çështjeve të rezultuara gjatë hetimit dhe për të cilat subjekti i rivlerësimit kërkoi që të pezullohet vlerësimi i tyre deri në një konkluzion nga organi kompetent apo ato lidhur me pasuritë e krijuara pas deklaratës *Vetting*, për sa kohë çdo konkluzion lidhur me to nuk do të arrinte të ndryshonte vlerësimin përfundimtar të trupit gjykues lidhur me këtë kriter të rivlerësimit dhe vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra

29. Në përfundim, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurive të deklaruara, pasi ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshme të pasurisë, në kuptim të nenit "D", pikat 1 dhe 3, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

30. Trupi gjykues arrin në konkluzionin se nga vlerësimi në tërësi i pasurisë së subjektit të rivlerësimit, subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe gjendet në kushtet e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në pikat 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artan Hazbi, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 26.4.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI

Kryesuese

Valbona SANXHAKTARI

Relatore

Pamela QIRKO

Anëtare

Sekretare gjyqësore

Elda Faruku